

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5825
E premte, 12 korrik 2019
çmimi 0.40 €

Përkujtohet 24-vjetori i masakrës së Srebrenicës



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

OPINION

DIPLOMATI SI PËRFAQËSUES I UÇK-SË, PA REPUBLIKË E PA AMBASADA KLASIKE

Prof. dr. Hakif BAJRAMI

AKTUALE



HARADINAJ E KONFIRMON SE KA FOLUR ME KOMEDIANËT RUSË

SHSKUK-ja DHE KDI-ja NËNSHKRUAJNË MEMORANDUM PËR MONITORIM TË PROCEDURAVE TË PROKURIMIT

F. 6

EKONOMI

GJYKATA KOMERCIALE HYN NË PROGRAMIN LEGJISLATIV TË QEVERISË PËR VITIN 2019

ATK-ja DHE DOGANA T'I VAZHDOJNË LEHTËSIRAT TATIMORE DHE DOGANORE PËR BIZNESET

F. 9

KULTURË

ËNDRRAT E KUQE

Sabile KEÇMEZI-
BASHA



SPORT

FAZLIU: NË 'FADIL VOKRRI' LUAJMË EDHE PËR KOSOVËN

F. 20

KOALICIONI QEVERISËS NUK I DRUHET MOCIONIT TË MOSBESIMIT TË OPOZITËS

PAN-i nuk i frikësohet mocionit të opozitës



Përfaqësuesit e koalicionit qeverisës nuk besojnë në seriozitetin e opozitës për mocionin e mosbesimit ndaj qeverisë Haradinaj. Zyrtarët e subjekteve të koalicionit qeverisës kanë deklaruar

për gazetën "Epoka e re" se partitë opozitare vetëm po bëjnë zhurmë për këtë çështje dhe nuk kanë guxim ta dërgojnë mocionin në Kuvend për votim ngaqë, sipas tyre, nuk i kanë

votat për një gjë të tillë. Kurse përfaqësuesit e opozitës kanë thënë se shumë shpejt do t'i sigurojnë 61 votat e nevojshme dhe se qeverinë aktuale nuk do ta zë vjeshta e vonë

Veseli: Pensionimi i parakohshëm dhe sigurimi shëndetësor i policëve do të adresohen së shpejti

"Do ta përkrahim Policinë e Kosovës, sidomos pensionimin e parakohshëm të policëve, sigurimin jetësor, sigurimin shëndetësor si dhe krijimin e kushteve infrastrukturore me qëllim të luftimit të krimit të organizuar dhe korrupsionit si dhe janë me interes strategjik siguria dhe stabiliteti në çdo pjesë të Kosovës", ka thënë të enjten Veseli pas vizitës që i ka bërë Policisë së Kosovës



Ende s'ka vendim zyrtar se çfarë do të ndodhë me numrat e 'Z-Mobile'-s

FAQE 9

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë, p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Përkujtohet 24-vjetori i masakrës së Srebrenicës

Të enjten u shënuar 24-vjetori i masakrës së Srebrenicës, ku qindra-mija familjarë të të vrarëve, zyrtarë shtetërorë, përfaqësues të bashkësisë ndërkombëtare e diplomatë vizituan qendrën përkujtimore Potoçari. Në lidhje me këtë masakër reagueshan edhe krerët shtetërorë të Republikës së Kosovës

SARAJEVË, 11 KORRIK - Bosnjë e Hercegovina ka shënuar të enjten 24-vjetorin e masakrës së Srebrenicës, më e rënda në Evropë që nga Lufta e Dytë Botërore.

Të enjten mijëra familjarë të të vrarëve, zyrtarë shtetërorë, përfaqësues të bashkësisë ndërkombëtare, diplomatë, e të tjerë vizituan qendrën përkujtimore Potoçari.

Në korrik të vitit 1995, forcat serbe të Bosnjës vranë mbi 8 mijë burra dhe djem myslimanë në Srebrenicë e cila ishte shpallur atëbotë "zonë e sigurt" nga Kombet e Bashkuara.

Më 9 korrik 1995, ish-udhëheqësi i serbëve të Bosnjës, Radovan Karaxhiq, urdhëroi pushtimin e Srebrenicës dhe më 11 korrik forcat serbe të drejtuara nga gjenerali serb, Ratko Mladiq e morën qytetin, ka njoftuar voa.

Për disa ditë me radhë forcat serbe vranë rreth 8 mijë veta, trupat e të cilëve u hodhën në varreza masive. Edhe 24 vjet më pas vazhdon puna për t'i gjetur dhe identifikuar viktimat identifikimi i të cilave është i vështirë, pasi trupat ishin copëtuar nga ekskavatorët që i hidhnin në varre. Dhe çdo vit më 11 korrik, eshtrat e atyre që identifikohen gjatë vitit të fundit varrosen në Qendrën përkujtimore në Potoçari. Të enjten në atë qendër u varrosën 33 viktima.

Dy ish-udhëheqësit e serbëve të Bosnjës, Radovan Karaxhiq dhe Ratko Mladiq, janë dënuar me burgim të përjetshëm për gjenocidin në Srebrenicë dhe mizoritë në luftën e Bosnjës, që la pas vetes mbi 100 mijë të vrarë dhe miliona të zhvendosur.

E cilësuar si gjenocid nga Gjykata ndërkombëtare për krime lufte dhe Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë, masakra e Srebrenicës nuk cilësohet si e tillë nga serbët e Bosnjës dhe Serbia zyrtare. Në vitin 2015 Rusia i vuri veton një projektrezolute të OKB-së që e dënonte si akt gjenocidi masakrën në Srebrenicë.

DASH: Kapitull i dhimbshëm që nuk mund të mohohet e as harrohet

Departamenti amerikan i Shtetit, tha të enjten se "populli amerikan i bashkohet popullit të Bosnjë e Hercegovinës për t'i nderuar kujtimet për më shumë se 8 mijë viktima të pafajshme", sot kur "shënojmë 24 vjet nga gjenocidi në Srebrenicë".

Në një deklaratë me rastin e këtij përvjetori, thuhet se "ky kapitull i dhimbshëm në historinë evropiane, nuk duhet të mohohet e as të harrohet. Ne qëndrojmë përkrah atyre që kërkojnë drejtësi. Ne ritheksojmë mbështetjen tonë të vazhdueshme për ata që punojnë për të nderuar dinjitetin e të gjitha

viktimize, përfshirë edhe ata që ende presin një vend për t'u prehur. Ngjarjet tragjike të së kaluarës na kujtojnë nevojën që të punojmë të bashkuar për një të ardhme më të mire, një të ardhme të qëndrueshme, përparimtare dhe gjithëpërfshirëse për të gjithë qytetarët e Bosnjë e Hercegovinës".

Duke theksuar se ShBA-ja mbetet një partner i palëkundur i popullit të Bosnjë e Hercegovinës, deklarata thekson se "sot derisa kujtojmë të rënë, ne ritheksojmë angazhimin tonë për të ndërtuar paqen dhe përparimin në të gjithë rajonin dhe për t'u siguruar që tragjedi të tilla kurrë më nuk do të ndodhin".

Ndërkaq, shefja në largim e politikës së Jashtme të Bashkimit Evropian, Federica Mogherini dhe komisionari për zgjerim, Johannes Hahn, në një deklaratë të përbashkët thanë se "sot përkujtojmë gjenocidin në Srebrenicë, një nga momentet më të errëta të njerëzimit në historinë bashkëkohore evropiane".

Në deklaratë thuhet mes tjerash se duhet të marrë fund "mosndëshkeshmëria".

"Nuk ka vend për retorikë nxitëse, për mohimin, revizionizmin apo glorifikimin e kriminelëve të luftës.

Përpjekjet për të rishkruar historinë në Bosnjë dhe Hercegovinë apo kudo, janë të papranueshme", thuhet mes tjerash në deklaratë.

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka përkujtuar 24-vjetorin e masakrës në Srebrenicë ku janë vrarë rreth 8 000 mijë njerëz.

Ai ka thënë se është fatkeqësi që edhe pas dy dekadave, kriminelët serbë, autorë të këtyre krimeve makabre në Bosnjë e Hercegovinë dhe Kosovë nuk janë dënuar nga drejtësia ndërkombëtare.

"Masakra e Srebrenicës, 24 vjet më parë, rikthej tragjedinë e Luftës së Dytë Botërore - të popullvrasjeve masive. Ky gjenocid i urdhëruar nga regjimi i Millosheviqit, ku u vranë rreth 8 mijë njerëz, ishte edhe një paralajmërim se deri në çfarë mase mund të shkonte çmenduria e regjimit serb. Me të njëjtën logjikë, ky regjim vrasar vazhdoi masakrat edhe në Kosovë në vitet 1998-1999. Është fatkeqësi që edhe pas dy dekadave, kriminelët serbë, autorë të këtyre krimeve makabre në Bosnjë e Hercegovinë dhe Kosovë, nuk janë dënuar nga drejtësia ndërkombëtare. Sot, 24 vjet pas masakrës së Srebrenicës, me dhimbje të madhe i kujtojmë tmerret që ndodhën atje", ka shkruar Thaçi në

llogarinë e vet në "Facebook".

Kurse kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka thënë se kjo masakër është një prej krimeve më mizore që kanë ndodhur në Evropë pas Luftës së Dytë Botërore. Ai ka theksuar se masakra e Srebrenicës nuk ishte as fillimi dhe as fundi i krimeve të regjimit të atëherëshëm serb.

Veseli ka rikujtuar se vetëm tri vjet pas Srebrenicës, të njëjtat pamje të mizorisë u shfaqën në fshatrat dhe qytetet e Kosovës.

"Sot në përvjetorin e 24-të, ne i bashkohemi përkujtimin të masakrës së Srebrenicës, një prej krimeve më mizore në Evropën e pasluftës së dytë botërore. Kjo masakër nuk ishte as fillimi dhe as fundi i krimeve të regjimit të atëherëshëm serb. Vetëm tre vjet pas Srebrenicës, të njëjtat pamje të mizorisë u shfaqën në fshatrat dhe qytetet e Kosovës. Dhe ndonëse kanë kaluar dekada, drejtësia ende nuk është vendosur, por koha nuk e zhvlerëson krimin dhe as drejtësinë. Serbia do të përgjigjet për gjenocidin në Kosovë, siç është përgjigjur për gjenocidin në Srebrenicë. Kjo është e pashmangshme", ka shkruar Veseli në llogarinë e vet në "Facebook".



Basha në festën e Ambasadës amerikane

TIRANË, 11 KORRIK - Ambasada amerikane në Tiranë ka shënuar 4 Korrikun, festën kombëtare të shteteve të Bashkuara të

Amerikës. Kreu i opozitës Lulzim Basha është parë të mbërrijë në këtë festë me ish-ministrin e Punëve të Jashtme Besnik Mustafaj,

siç shihet edhe nga fotot e siguruar nga "Top Channel".

Festa kombëtare e ShBA-së festohet me 4 Korrik, por

për shkak të situatës post zgjedhore u kremtuar të enjten, përmes një ceremonie zyrtare në ambientet e Ambasadës amerikane.



Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka mbajtur konferencë për medie

Haradinaj: Kosova nuk dorëzohet, në dialog shkojmë vetëm për njohje

Kryeministri i vendit, Ramush Haradinaj, ka bërë me dije se Kosova do të shkojë në proces të dialogut me Serbinë vetëm për të marrë njohjen reciproke në kufijtë ekzistues. Ai e ka quajtur të tejkaluar idenë e ndarjes së Kosovës. Kryeministri Haradinaj ka thënë se dialogu ndërmjet Kosovës dhe Serbisë duhet ta ketë një fund dhe jo të vazhdohet me vite të tëra siç ka ndodhur deri më tani



të partnerëve të koalicionit qeverisës. Ai ka thënë se marrëdhëniet nuk tregojnë për prishje të koalicionit. "Marrëdhëniet e

Aleancës dhe Nismës datojnë që nga VLAN-i, që atëherë kemi pasur partneritet. Ka debate publike të zyrtarëve të partive,

por nuk paraqesin qëndrimet në koalicion. Marrëdhëniet nuk tregojnë për prishje të koalicionit", ka theksuar Haradinaj.

EPOKA E RE

Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 11 KORRIK - Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka thënë të enjten se ka tendenca që vendi ynë të ftohet vetëm për proces të dialogut me Serbinë por, sipas tij, një gjë e tillë do të jetë e papranueshme. Haradinaj ka bërë me dije se Kosova do të shkojë në dialog vetëm për njohje reciproke në kufijtë ekzistues. "Ajo çka ka mbetur është njohja e Kosovës nga ana e Serbisë. Janë dy tema që kanë mbetur për t'u zgjidhur, njohja e Kosovës dhe tregu i lirë. Në një farë mënyre ka përpjekje që të na ftojnë vetëm për proces, por nuk do të pranojmë. Kosova po hyn në procesin e dialogut të konsoliduar. Do të shkojmë në proces të dialogut vetëm për ta marrë njohjen reciproke në kufijtë ekzistues. Pra, kemi kërkuar një marrëveshje kornizë për negociim të njohjes reciproke në kufijtë ekzistues. Kosova nuk ka nevojë të hyjë në diçka të paqartë", është shprehur kryeministri Haradinaj në një konferencë për medie pas mbledhjes së rregullt të Qeverisë së Kosovës.

Ai ka thënë se dialogu ndërmjet Kosovës dhe Serbisë duhet ta ketë një fund dhe jo të vazhdohet me vite të tëra siç ka ndodhur deri më tani. "Ne jemi që 20 vjet në proces dhe nuk po i shihet

fundi këtij procesi. Jam kundër që Kosova të dorëzohet dhe kjo nuk duhet të bëhet për asnjë çmim. Ne duhet të jemi të durueshëm dhe të negociojmë vetëm për atë që është kryesorja, pra njohja reciproke. Nëse pranojmë të ulemi do të mbetemi në proces me vite të tëra siç jemi realisht, nëse vazhdojmë të qëndrojmë dhe nuk dorëzohemi, atëherë mund të kemi sukses", ka deklaruar Haradinaj, duke shtuar se është me rëndësi që Kosova ka kryer plot tema të brendshme siç janë formimi i ushtrisë dhe zgjidhja e statusit të "Trepçës", të cilat, sipas tij, ia mundësojnë Kosovës konsolidimin e mëtejshëm.

Në këtë konferencë për medie kryeministri Ramush Haradinaj ka folur edhe për liberalizimin e vizave, duke thënë se Holanda është skeptike për këtë proces. Megjithatë, ai ka thënë se qeveria që drejton është duke bërë përpjekje t'ia sqarojë shtetit holandez qëndrimin e Kosovës. "Ka skepticizëm dhe po përpjekim që t'u përgjigjemi çdo pyetjeje, edhe të Holandës. Unë personalisht u kam dërguar sqarime sa iu përket vizave. Liberalizimi është premtues, kemi marrë një konfirmim nga Gjermania", ka deklaruar Haradinaj.

Gjithashtu, në adresimin e tij para gazetarëve kryeministri ka folur edhe për raportet në mes

Haradinaj e konfirmon se ka folur me komedianët rusë

Shefi i qeverisë e ka komentuar edhe çështjen e përgjimeve të fundit të Zoran Zaevit i cili përmes telefonit ka biseduar me disa komedianë rusë ku, ndër të tjera, ka folur edhe për çështjen e Kosovës. Haradinaj ka theksuar se të gjithë liderët e rajonit, përfshirë edhe kryeministrin maqedonas, e kanë shqetësimit ndryshimin e territoreve. Në këtë kontekst,

kryeministri Haradinaj ka thënë se deklaratat e dëgjuara të kryeministrit Zoran Zaev nuk janë ndonjë risi. "Të gjithë e kanë shqetësimit lëvizjen e kufijve. Këto që i dëgjuam në ato përgjime nuk janë ndonjë risi. Ne kemi qenë në dijeni se Zoran Zaevi është kundër ndryshimit të kufijve, kundër ndërrimit të territoreve apo ndarjes së Kosovës", ka thek-

suar kryeministri Haradinaj, duke pranuar se ka marrë telefonatë edhe nga komedianët rusë. "Kam folur edhe me Poroshenkon, por edhe me komedianët. Për fat të mirë, biseda që kam bërë unë nuk ka dalë nga shablloni, e kam kërkuar njohjen dhe qaq. Me Zaevin nuk kam biseduar kohën e fundit", ka treguar kryeministri Haradinaj.

Krasniqi: Taksa nuk është problemi kryesor për mosvazhdimin e dialogut

PRISHTINË, 11 KORRIK - Ish-kryetari i Kuvendit të Kosovës, Jakup Krasniqi, ka thënë se taksa që ka vendosur Qeveria e Kosovës për mallrat serbe nuk është problemi kryesor për mosvazhdimin e dialogut. Ai përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook" ka shkruar se kjo taksë po shihet nga shumë faktorë të jashtëm si pengesa kryesore e vazhdimin të dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë. "Mbase taksa edhe mund të jetë si shkas, por problemi nuk është të shkasi, por të shkaqet që e sollën vendosjen e saj. Dhe shkaqet e shumta që e sollën taksën duhen kërkuar dhe janë

vetëm e vetëm në Beograd, aty ku nuk ka asnjë pendim, madje as formal për krimin e gjenocidit që Beogradi zyrtar ka kryer në Kosovë", ka thënë Krasniqi, duke shtuar se, përkundrazi, politika zyrtare në Beograd, kryesit e krimeve në luftë e të gjenocidit jo vetëm në Kosovë, i ka shpallur heronj dhe i trajton si heronj. "Tekefundit, vetë fakti se kjo politikë nuk e ka pranuar gjenocidin serb në Bosnje e Hercegovinë, Kroaci e në Kosovë, bile as është distancuar nga politikat e gjenocidit, tregon se politika zyrtare e Beogradit ato veprime edhe sot e gjithë ditën i konsideron të drejta

dhe në të mirë të popullit serb", ka deklaruar ish-kryetari i Kuvendit të Kosovës.

Krasniqi ka theksuar se problemi nuk është te taksa, por te mbrojtësit e politikave të krimit e të gjenocidit që e drejtojnë Serbinë. "Kushdo që i ka përcjellë zhvillimet në këtë pjesë të Ballkanit edhe në dhjetë vjetët e fundit e ka të qartë se ku fle lepuri, thonë serbët! Shkurt: Problemi nuk është te taksa, por te mbrojtësit e politikave të krimit e të gjenocidit që e drejtojnë Serbinë edhe sot. Prandaj taksa nuk është problemi kryesor për mosvazhdimin e dialogut", ka thënë Krasniqi.



Koalicioni qeverisës nuk i druhet mocionit të mosbesimit të opozitës

PAN-i nuk i frikësohet



Përfaqësuesit e koalicionit qeverisës nuk besojnë në seriozitetin e opozitës për mocionin e mosbesimit ndaj qeverisë Haradinaj. Zyrtarët e subjekteve të koalicionit qeverisës kanë deklaruar për gazetën "Epoka e re" se partitë opozitare vetëm po bëjnë zhurmë për këtë çështje dhe nuk kanë guxim ta dërgojnë mocionin në Kuvend për votim ngaqë, sipas tyre, nuk i kanë votat për një gjë të tillë. Kurse përfaqësuesit e opozitës janë shprehur të bindur se shumë shpejt do t'i sigurojnë 61 votat e nevojshme dhe se qeverinë aktuale nuk do ta zë vjeshta e vonë

EPOKA E RE

Muhamet KOCI

PRISHTINE, 11 KORRIK - Subjektet opozitare deri më tani kanë mbledhur 58 nënshkrime për mocionin e mosbesimi ndaj qeverisë Haradinaj, por ende nuk kanë treguar se kur mund ta dërgojnë mocionin për

votim në Kuvend. Kësaj iniciative të opozitës nuk po i frikësohet qeveria.

Zyrtarët e partive të koalicionit qeverisës PAN kanë thënë për gazetën "Epoka e re" se opozita në këtë drejtim po tregohet joserioze. Sipas tyre, partitë opozitare vetëm po deklarohen për këtë çështje dhe nuk po

marrin asnjë veprim konkret për ta çuar mocionin në Kuvend.

Deputeti i Kuvendit të Kosovës nga radhët e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Zenun Pajaziti, ka deklaruar se kjo qeveri nuk ndihet e rrezikuar nga opozita. "Për shëndetin e demokracisë dhe

për të mirën e vendit gjithmonë pushteti do të duhej të ndihej i 'rrezikuar' nga nismat e opozitës për votëbesim apo rrezim. Në rastin tonë nuk është as njëra e as tjetra. Edhe qeveria herë pas here po sillet tepër komode, nganjëherë edhe me fodullëk. Në anën tjetër, opozita krejt joserioze dhe me dallime të mëdha deklarohet dhe sillet në jetën politike. Kurdo që numrat në Kuvend ndryshojnë do të ndryshojë edhe skena politike dhe rrjedhat në vend", ka thënë Pajaziti për gazetën "Epoka e re". Sipas tij, zgjedhjet e reja nuk do të ishin zgjedhje për Kosovën në këtë çast. "Zgjedhjet nuk besoj se do të zgjidhnin asnjërin prej këtyre problemeve me të cilat po përballlet aktualisht vendi ynë siç janë: dialogu, vizat apo edhe sfidat e tjera që po lidhen me gjykimin e të kaluarës sonë. Po ashtu, s'besoj se do t'i

zgjidhnin as vështirësitë parti-ake që i kanë ata që po i përmendin përditë zgjedhjet", ka deklaruar Pajaziti.

Ministri i Infrastrukturas dhe Transportit, Pal Lekaj, duke i komentuar deklarimet e opozitës për mocion, ka thënë se ato janë bërë refrene të bajatshme për qytetarët e Kosovës. "Nuk kemi pse të frikësohemi prej çfarëdo skenari që mund të mendojë opozita. Reagimet e tyre janë refrene të bajatshme për qytetarët si reaksion i mungesës së alternativës. Puna jonë ka folur tashmë prandaj, pa pasur nevojë të bëhen qesharakë, le ta organizojnë mocionin, ndërsa ne jemi të gatshëm për zgjedhje, edhe sikur ato të ndodhin nesër. Megjithatë, mandatin do ta përmbyllim siç parashihet në Kushtetutë", ka thënë Lekaj për gazetën.

Ndërsa kryetari i Këshillit Kombëtar të Nismës

t mocionit të opozitës



suksesin e mocionit të mosbesimit ndaj kësaj qeverie. Ata besojnë se shumë shpejt do t'i bëjnë 61 votat e nevojshme për ta rrëzuar këtë qeveri.

Nënkryetari i LDK-së, Haki Rugova, ka deklaruar për gazetën se mocioni do të ndodhë shpejt. Sipas tij, kjo qeveri nuk mund të shkojë më shumë se deri në vjeshtë të këtij viti. "T'ju them të drejtën, sa më shpejt që të ndodhë aq më mirë do të jetë. Është koha e duhur për rrëzimin e qeverisë. Kjo qeveri nuk mund të shkojë më tutje sesa në fillim të vjeshtës", është shprehur Rugova. Ai ka deklaruar se kjo qeveri ka dështuar në çështjet madhore për vendin. "Nuk besoj se ky koalicion mund t'i zgjidhë problemet madhore. Pavarësisht prej premtimeve, nuk ka liberalizim të vizave, dialogu ka ngecur dhe nuk ka zhvillime pozitive në politikën e jashtme në përgjithësi. Kemi probleme edhe në aspektin e qeverisjes së brendshme, ka keqmenaxhim të parësive publike, papunësia është shumë e madhe dhe më e dhimbshme është largimi i të rinjve nga Kosova. Ka shumë arsye që LDK-ja insiston dhe kërkon domosdo zgjedhje. Pra, porsa të arrijmë t'i bëjmë votat, menjëherë do ta ngrehim mocionin i cili ka për qëllim rrëzimin e qeverisë. Në fund të fundit, kjo është detyra e opozitës", ka thënë Rugova.

Edhe deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje, Rexhep Selimi, ka thënë se vendi duhet të shkojë sa më parë në zgjedhje. "Sa më shumë që zgjatë kjo qeveri aq më shumë militantë partiakë dhe zyrtarë të koalicionit qeverisës do të kapen nga policia dhe drejtësia për korrupsion, zhvatje dhe keqpërdorim të detyrave zyrtare. Kështu që, nga zgjedhjet e parakohshme në Kosovë shpëton Kosova nga kjo qeveri e korruptuar, por edhe vetë partitë e koalicionit do të përfitonin duke e ndalur kusarinë e militantëve partiakë në institucione dhe ndërmarrje publike", ka vlerësuar Selimi, duke shtuar se nëse shkohet në zgjedhje, shpëton Kosova nga koalicioni i korrupsionit. Ndërsa kryetari i PSD-së, Shpend Ahmeti, ditë më parë ka pranuar se opozita nuk i ka votat e mjaftueshme për ta rrëzuar qeverinë. Sipas tij, po t'i kishte 61 vota opozita menjëherë do ta ftonte seancën për ta votuar mocionin e mosbesimit ndaj qeverisë.

Thaçi thotë se Zaevi i kërkoi falje për deklaratat për shkëmbim terriroresh

PRISHTINË, 11 KORRIK - Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka thënë të enjten se kryeministri i Maqedonisë së Veriut, Zoran Zaev, i ka kërkuar falje në lidhje me deklaratat në të cilat ai përmend presidentin e Kosovës dhe atë të Serbisë, të përfshirë në negociatë për ndarje dhe shkëmbim terriroresh. Thaçi ka thënë se Zaevi ka rënë pre e mashtrimit nga humoristët rusë, të cilët janë prezantuar si ish-presidenti i Ukrainës, Petro Poroshenko, e që kanë folur edhe për ndarjen e Kosovës.

Edhe Zaev, në një konferencë për media në Shkup, e ka pranuar se ka rënë pre e këtij mashtrimi. "Unë mbrëmë kam zhvilluar një bisedë telefonike, rreth 20 minuta, me kryeministrin Zaev. Ai më ka telefonuar për t'u sqaruar për

atë që ai ka biseduar me njerëzit që e kanë thirrur. Më ka thënë shumë qartë se kjo ka qenë një rrethanë, në të cilën ka rënë pre e mashtrimit", ka deklaruar presidenti Thaçi.

Këto komente ai i bëri në Prishtinë, pas takimit lamtumirës me shefen e misionit evropian për sundimin e ligjit EULEX, Alexandra Papadopoulou.

Në këtë bisedë telefonike me humoristët rusë, të publikuar në "Youtube", Zaev flet se si Thaçi është pajtuar që komunat në veri të Kosovës, të banuara me shumicë serbe, t'i takojnë Serbisë. "Për ato që ka thënë se gjoja dhjetë komuna do t'i jepen Serbisë, ai ka treguar se i ka folur duke u bazuar në thashetheme, në dezinformata dhe në të dhënat apo lansimet e gazetës 'Sputnik' dhe thashethemet

ruse. Këto janë fjalët që mua m'i ka thënë Zaevi. Më ka kërkuar falje mua personalisht dhe Kosovës. Në të njëjtën kohë nuk ka asnjë fakt, asnjë evidencë, as informacion zyrtar për atë që ka deklaruar, por të gjitha janë të bazuara në thashetheme", ka thënë Thaçi. Ai ka shtuar se raportet me Maqedoninë e Veriut kanë qenë dhe do të mbesin korrekte. "Kosova do të vazhdojë ta fuqizojë perspektivën e saj euroatlantike", ka thënë Thaçi. Në bisedën e publikuar që Zaevi ka zhvilluar me humoristët rusë, ai dëgjohet duke thënë se për idenë e ndryshimit të kufijve, e cila, sipas tij, është ide e presidentëve të Kosovës dhe Serbisë, janë shprehur kundër edhe liderë botërorë, përfshirë kancelaren gjermane Angela Merkel.



Socialdemokrate, Jakup Krasniqi, ka ftuar opozitën ta bëjë mocionin nëse i ka numra dhe të mos bëjë zhurmë. "Opozita nuk ka pse bën zhurmë për këtë çështje. Ajo duhet ta bëjë mocionin nëse i ka numrat", ka theksuar Krasniqi, duke shtuar se nuk është i kënaqur me zhvillimet politike dhe largimin e të rinjve nga Kosova. "Nëse qytetarët e Kosovës nuk janë të kënaqur me mënyrën se si qeveriset vendi, atëherë asnjë njeri politik nuk ka mundësi që të jetë i kënaqur kur i sheh të rinjtë e të rejtat e këtij vendi të largohen nga atdheu. Nga mënyra se si komunikohet në publik edhe nuk duket se komunikimi është i duhuri, pra lë për të dëshiruar shumë", është shprehur Krasniqi për "Epokën e re". Pavarësisht prej qëndrimeve të partive të koalicionit qeverisës, subjektet opozitare janë optimiste për

Ministrja Hoxha para studentëve të Akademisë Verore: Agjenda evropiane e bashkon rajonin

EPOKA E RE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 11 KORRIK - Në ligjëratën për studentët e Akademisë Verore Ndërkombëtare Kosova 2019, ministrja e Integritimit Evropian, Dhurata Hoxha, ka prezantuar vizionin e ardhshëm për vendin dhe angazhimin për t'u bashkuar në familjen e kombeve të Bashkimit Evropian. Kjo akademi ka mbledhur 55 studentë nga universitetet prestigjioze nga 30 vende të të gjitha kontinenteve dhe ka në fokus temën "Ndërtimi i paqes në zonat pas konfliktit - diplomacia, udhëheqja dhe negociatat". Ministrja Hoxha ka thënë se agjenda evropiane bashkon të gjithë, pavarësisht përkatësisë etnike, fetare apo politike. "Kjo është një rrugë që kërkon përpjekjet më të forta nga ana jonë për ta përshpejtuar ritmin e reformave të brendshme. Ne e dimë shumë mirë se historia mund t'i ndajë njerëzit, veçanërisht në rajonin tonë. Kjo është arsyeja pse ne duhet

të bëjmë historinë duke punuar së bashku për një të ardhme më të mirë. Dhe, mënyra më e mirë për ne për të arritur këtë si vende individuale, por edhe si një rajon, është si anëtarë të barabartë brenda BE-së", ka thënë Hoxha.

Në fjalën e saj, ministrja Hoxha ka folur për nënshkrimin e MSA-së dhe reformat, duke përfshirë masat për forcimin e sundimit të ligjit, nxitjen e zhvillimit ekonomik dhe nxitjen e bashkëpunimit rajonal. Ndërsa për liberalizimin e vizave, ajo ka thënë se vendimi për liberalizimin e vizave qëndron në duart e Këshillit të Ministrave.

Hoxha ka thënë se mungesa e liberalizimit të vizave po ndikon më së shumti tek të rinjtë të cilët janë duke u privuar nga përjetimi dhe përqaftimi i vlerave evropiane si bashkëmoshatarët e tyre në rajon. "Heqja e regjimit të vizave ka ndikim të drejtpërdrejtë në nxitjen e ekonomisë, nxitjen e partneriteteve, promovimin e kontaktit ndërkulturor dhe rritjen e shkëmbimit profesional



dhe arsimor. Një perspektivë e qëndrueshme e BE-së për Ballkanin Perëndimor është çelësi për paqen dhe stabilitetin në rajon", ka potencuar ministrja Hoxha, duke shtuar se duhet një BE më e

angazhuar në rajon. "Ne vlerësojmë investimet e shteteve anëtare të BE-së në progresin e vendit tonë dhe ne jemi të vendosur ta vazhdojmë punën e vështirë, por të nevojshme për reformat", ka thënë ministrja

Hoxha, duke shtuar se do ta vazhdojnë punën për forcimin e institucioneve demokratike, promovimin e fjalës së lirë dhe ruajtjen e të drejtave të barabarta për të gjithë qytetarët tanë pa dallim.

ShSKUK-ja dhe KDI-ja nënshkruajnë memorandum për monitorim të procedurave të prokurimit

EPOKA E RE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 11 KORRIK - Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës (ShSKUK) dhe Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) kanë nënshkruar të enjten një memorandum të bashkëpunimit. Në emër të ShSKUK-së këtë memorandum e ka nënshkruar drejtori i përgjithshëm, dr. Basri Sejdiu, kurse në emër të KDI-së, drejtori Ismet Kryeziu. Ata e vlerësuan shumë të rëndësishëm fuqizimin e bashkëpunimit të institucioneve publike me sektorin joqeveritar, i cili ka për qëllim rritjen e llogaridhënies, transparencës dhe qeverisjes së mirë në

procesin e prokurimit në institucionet publike në Kosovë. Po ashtu, për përfundimin e zbatimit të legjislacionit primar dhe sekondar në fushën e prokurimit publik si dhe për aplikimin e prokurimit elektronik në të gjitha aktivitetet e prokurimit publik. Memorandumi i nënshkruar parasheh identifikimin e problemeve në procesin e prokurimit publik përmes shqyrtimit të disa kontratave në faza të ndryshme të prokurimit, ofrimin e rekomandimeve të dala pas procesit të monitorimit të tenderëve, rritjen e përgjegjësisë së autoriteteve kontraktuese për t'i shmangur praktikën e dëmshme për hartimin e kriterëve për tender, rritjen e



përgjegjësisë së autoriteteve kontraktuese për rritjen e efikasitetit dhe efektivitetit në menaxhimin e kontratave pub-

like dhe nxitjen e autoriteteve kontraktuese për rritjen e transparencës dhe të llogaridhënies që do të ndikojnë në informimin

e qytetarëve në shpenzimet e fondeve publike. ShSKUK-ja do të sigurojë transparencë në procedurat e prokurimit publik në të gjitha fazat, për aq sa lejon Ligji i Prokurimit Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092; Do të ofrojë, po ashtu, qasje në dosjet e tenderëve bazuar në ligjin për qasje në dokumente publike dhe përgjegjësitë e këtij memorandum, qasje për monitorim të kontratave gjatë fazës së ekzekutimit të kontratave/realizimit në terren, gatishmëri për adresim të rekomandimeve nga KDI-ja, të dala nga monitorimi i procesit të prokurimit.

Vazhdon aplikimi për pranim të studentëve të rinj në UShAF

FERIZAJ, 11 KORRIK (ER) - Në Universitetin e Shkencave të Aplikuara në Ferizaj (UShAF) po vazhdon aplikimi i rinjve për pranim në studime për vitin akademik 2019/20. Të enjten ka qenë dita e dytë e konkursit dhe

deri më tani po shfaqet interesim i madh për aplikim në programet të cilat UShAF i ka hapur në afatin e parë të konkursit. Arianita Jashari, e cila ka aplikuar në programin

Inxhinieri Industriale me Informatikë dhe Arta Kamberi, e cila ka aplikuar në programin Arkitekturë e Interierit dhe Dizajn i Mobileve, ishin ndër aplikueset e para të cilat me dëshirë të madhe zgjodhën

Shkencat e Aplikuara në Ferizaj dhe, sipas tyre, arsyet që kanë përzgjedhur këtë universitet janë kushtet e krijuara për studentë, cilësia, praktikën e studentëve dhe aktivitetet e shumta që organizon universiteti.



Veseli: Pensionimi i parakohshëm dhe sigurimi shëndetësor i policëve do të adresohen së shpejti

"Do ta përkrahim Policinë e Kosovës, sidomos pensionimin e parakohshëm të policëve, sigurimin jetësor, sigurimin shëndetësor si dhe krijimin e kushteve infrastrukturore me qëllim të luftimit të krimit të organizuar dhe korrupsionit si dhe është në interes strategjik siguria dhe stabiliteti në çdo pjesë së Kosovës", ka thënë të enjten Veseli pas vizitës që i ka bërë Policisë së Kosovës



realizimin e objektivave të Policisë së Kosovës për gjashtëmujorin e parë të këtij viti.

Qalaj ka folur për rezultatet pozitive në fusha të ndryshme, edhe përkundër sfidave të

ndryshme me të cilat ballafaqohet Policia e Kosovës gjatë kryerjes së punës.

**EPOKA
ERE** **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 11 KORRIK - Policinë e Kosovës e ka vizituar të enjten kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ku është pritur nga drejtori i përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Rashit Qalaj, me të cilin ka diskutuar për çështje të rëndësishme rreth sigurisë së përgjithshme në vend si dhe çështje të tjera për mirëqenien e zyrtarëve policorë. Gjatë fjalimit të tij Veseli ka thënë se janë të vetëdijshëm për sfidat dhe vështirësitë me të cilat ballafaqohet Policia e Kosovës gjatë kryerjes së detyrave. "Do ta përkrahim Policinë e Kosovës, sidomos pensionimin e parakohshëm të policëve, sigurimin jetësor, sigurimin shëndetësor si dhe krijimin e

kushteve infrastrukturore me qëllim të luftimit të krimit të organizuar dhe korrupsionit si dhe është në interes strategjik siguria dhe stabiliteti në çdo pjesë së Kosovës", ka thënë Veseli, duke shtuar se këto çështje do të adresohen shumë shpejt.

Ai ka falënderuar Policinë e Kosovës për sigurimin e një ambienti të sigurt për të gjithë qytetarët e Kosovës si bartëse e përgjegjësisë për sigurinë në Kosovë. Po ashtu, ka theksuar se Policia e Kosovës është një nga institucionet më profesionale dhe më e besueshme në rajon. Në takimin i cili është realizuar në ambientet e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Kosovës, Rashit Qalaj ka falënderuar kryetarin e Kuvendit për vizitën e tij, duke e njoftuar atë për angazhimet, aktivitetet dhe

Rashit Qalaj kërkon aktivitete të shtuara të policisë gjatë sezonit veror



PRISHTINË, 11 KORRIK (ER) - Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Rashit Qalaj, ka zhvilluar të enjten një takim me stafin menaxhues, përfshirë drejtorët e drejtorive rajonale të policisë dhe shefat e njësisë të trafikut rajonal dhe autostradës. Në këtë takim është diskutuar për gjendjen e përgjithshme të sigurisë në vend, duke përfshirë edhe sigurinë në trafikun rrugor.

Referuar të dhënave statistikore për gjashtëmujorin e parë të këtij viti krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, ka rezultuar se ka rënie të veprave penale dhe të aksidenteve në trafik. Po ashtu, është diskutuar edhe për masat dhe aktivitetet policore në ditët në vijim gjatë sezonit veror, ku nga drejtori i Policisë së

Kosovës është kërkuar të ketë aktivitete shtesë dhe prani policore në çdo pjesë të vendit, përfshirë rrugët lokale/fshatit, rajonale, nacionale dhe autostrada. Meqë këtë periudhë kohore e karakterizon edhe ardhja e bashkatdhetarëve dhe organizimi i ahengeve të ndryshme familjare, ai ka kërkuar nga policia që të jetë sa më tepër i pranishëm dhe në të njëjtën kohë të ndërmerren masa për ofrimin e sigurisë në trafik dhe masa parandaluese të dukurive të tjera të kundërligjshme. Në këtë takim është theksuar se policia do ta vazhdojë bashkëpunimin dhe bashkërendimin e aktiviteteve edhe me institucionet lokale dhe ato qendrore.

Haradinaj pret në zyrë Limajn, diskutojnë për punën e qeverisë

PRISHTINË, 11 KORRIK (ER) - Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka pritur të enjten në takim pune

zëvendësin e tij, Fatmir Limaj, me të cilin ka biseduar për zhvillimet e fundit në vend dhe për agjendën e qeverisë.

"Takim pune me zëvendëskryeministrin Fatmir Limaj, për të diskutuar për zhvillimet e fundit politike në

vend dhe për ta bashkërenduar agjendën qeverisëse", ka shkruar Haradinaj në llogarinë e vet në "Facebook".



Gjykata Komerciale hyn në programin legjislativ të qeverisë për vitin 2019

PRISHTINË, 11 KORRIK (ER) - Kabineti qeveritar ka miratuar të enjten propozimin e ministrit të Drejtësisë, Abelard Tahiri, që në Programin Legjislativ për vitin 2019 të përfshihet edhe Projektligji për Gjykatën Komerciale. Themelimi i kësaj gjykate del si rezultat i analizave të procesit të rishikimit funksional të sektorit të sundimit të ligjit, rezultate këto që rekomandojnë fuqishëm themelimin e kësaj gjykate.

Po ashtu, me propozim të ministrit të Punës dhe Mirëqenies Sociale, Skender Reçica, aprovimin e kabinetit qeveritar e mori edhe vendimi për pagesën e pensionit të papaguar për vitet 2011-2015, në vlerë prej 18 mijë eurosh për bashkëshorten e Ismet Jasharit - komandant

"Kumanovës".

Në këtë mbledhje të qeverisë kryeministri Ramush Haradinaj ka kërkuar nga ministri i Financave, Bedri Hamza, sqarim lidhur me kërkesën dhe propozimin e Komunës së Gjilanit lidhur me çështjen e ujit të pijes në këtë komunë dhe një kërkesë të K.R.U Gjakova lidhur me buxhetin e paraparë për renovimin e gypave në këtë ujësjellës.

Ministri i Financave, Bedri Hamza, ka thënë se ndërimi i gypave të azbestit është projekt jetik për qytetarët e Komunës së Gjakovës dhe si Ministri e Financave në proceset e ardhshme buxhetore, po edhe gjatë këtij viti, pas krijimit të rrethanave ligjore janë të gatshëm për mbështetjen e këtij projekti dhe për adresimin e kësaj çështje.



ATK-ja dhe Dogana t'i vazhdojnë lehtësirat tatimore dhe doganore për bizneset



PRISHTINË, 11 KORRIK (ER) - Politikat fiskale lehtësojnë operimet e sektorit privat në vend, kurse bizneset vazhdojnë të hasin probleme në fusha të ndryshme të legjislacionit tatimor dhe të procedurave doganore. Kështu u tha në forumin e politikave fiskale të organizuar nga Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë, ku u

diskutuan vështirësitë dhe pengesat e bizneseve në lidhje me Administratën Tatimore të Kosovës dhe Doganën e Kosovës.

Drejtori ekzekutiv i Odës Amerikane, Arian Zeka, ka thënë se Oda Amerikane mbetet e përkushtuar ta rrisë partneritetin me këto institucione për ofrimin e rekomandimeve të

bizneseve rreth çështjeve të cilat janë sfiduese për to, duke shtuar se nevojitet bashkëpunim më i madh në mes të institucioneve publike dhe përfaqësuesve të bizneseve.

Ndërsa Remzi Uka, kryeshef ekzekutiv i AFAM Group, ka theksuar se diskutime të tilla me aktorë relevantë rreth operimeve të bizneseve dhe barrier-

ave të cilat i hasin në tregti apo edhe sektorë të tjerë shërbejnë si adresë e bizneseve për adresimin e sfidave të tyre në mjedisin e të bërit biznes.

Drejtori i Doganës së Kosovës, Bahri Berisha, ka pohuar se në mesin e objektivave kryesore strategjike të institucionit që ai udhëheq mbeten zhvillimi i bizneseve përmes lehtësirave

tregtare si dhe avancimi dhe thjeshtëzimi i procedurave doganore.

Berisha ka shtuar se bizneset ende hasin në probleme të shumta në procedurat doganore si dhe barrierat ligjore të cilat pengojnë zhvillimin e mirëfilltë të tyre. Ai ka siguruar se Dogana është e angazhuar për ta vazhduar partneritetin me sektorin privat dhe do të mbetet transparente dhe e hapur të punojë ngushtë me bizneset të cilat punojnë me parimet ligjore të tregtisë.

Drejtori i Përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës, Ilir Murtezaj, ka përmendur, ndër të tjera, hartimin e ligjeve të reja në legjislacionin tatimor të cilat ndikojnë drejtpërdrejt te bizneset. Murtezaj ka thënë se një ndër qëllimet kryesore të politikave fiskale nga ana e ATK-së është krijimi i stabilitetit në tregun e vendit përmes përmirësimit të legjislacionit si dhe avancimin e mëtutjeshëm të bizneseve përmes lehtësirave tatimore, duke shtuar se bashkëpunimi me sektorin privat është kyç në këtë drejtim.

Biznesmenët turq njoftohen për mundësinë e investimeve në Kosovë

PRISHTINË, 11 KORRIK (ER) - Ministri i Financave, Bedri Hamza, ka pritur të enjten në takim një delegacion të përfaqësuesve të bizneseve nga Turqia, me të cilët ka diskutuar për rritjen e bashkëpunimit ekonomik mes të dy vendeve si dhe për mundësitë e rritjes së investimeve të bizneseve turke në Kosovë dhe anasjelltas.

Gjatë takimit ministri Hamza i ka informuar përfaqësuesit e bizneseve turke për situatën ekonomike në vend, me theks të veçantë për ambientin e të bërit biznes në Kosovë dhe për reformat e ndërmarra nga Ministria e Financave për krijimin e kushteve sa më të favorshme për zhvillimin e sektorit privat si bartës kryesor i zhvillimit

ekonomik.

Hamza ka theksuar se në Kosovë është krijuar një ambient i mirë i të bërit biznes dhe se nuk do të ketë rritje të tatimeve ekzistuese. Sipas tij, nuk do të ketë tatime të reja, por lirime dhe thjeshtëzime të procedurave. Me këtë rast, ministri Hamza i ka ftuar bizneset turke që të investojnë në Kosovë.



Ende s'ka vendim zyrtar se çfarë do të ndodhë me numrat e 'Z-Mobile'-s



Kryetari i Bordit të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (ARKEP), Kreshnik Gashi, ka raportuar të enjten në Komisionin Hetimor Parlamentar në lidhje me gjendjen në Telekomin e Kosovës dhe Vala, me ç'rast ka dhënë sqarime lidhur me licencimin e operatorëve virtualë, veçanërisht për "Z-Mobile". "Numeracioni është çështje e pronarit. Nëse nuk ka operator ata numra nuk mund të funksionojnë dhe është çështje e Telekomit se si e menaxhon këtë çështje. Telekomit i Kosovës dhe 'Z-Mobile', nëse nuk e vazhdojnë kontratën, numeracioni mbetet në Telekom, por ende nuk kemi vendim zyrtar se çfarë do të ndodhë", ka thënë Gashi

Mobile' e ka autorizimin e përgjithshëm. Numeracioni është çështje e pronarit. Nëse nuk ka operator ata numra nuk mund të funksionojnë dhe është çështje e Telekomit se si e menaxhon këtë çështje. Telekomit i Kosovës dhe 'Z-Mobile', nëse nuk e vazhdojnë kontratën, numeracioni mbetet në Telekom, por ende nuk kemi vendim zyrtar se çfarë do të ndodhë", ka thënë Gashi. Deputetja Albulena Haxhiu e ka pyetur Kreshnik Gashin se çfarë funksioni ka "Z-Mobile", shpesh apo diçka tjetër. Gashi ka theksuar se sa i përket paraardhësve nuk i ka takon të flasë, duke thënë se kontratat komerciale nuk janë objekt hetimi ose kompetencë e ARKEP-së. Kryesuesi i Komisionit, Visar Ymeri, ka deklaruar se kontrata mes "Telekomit" dhe "Z-Mobile"-s nuk është vetëm

komerciale pasi, sipas tij, ka efekt edhe në tregun e telekomunikimeve ngaqë kjo ka të bëjë me siguri kombëtare dhe mbrojtje të konsumatorëve. Sipas tij, ARKEP ka përgjegjësi ta shqyrtojë ose ta ketë pasur në arkiva kontratën në fjalë. Deputeti Haxhi Avdyli ka pyetur se nëse kontrata në mes të Telekomit dhe "Z-Mobile"-s ripërtërihet atëherë cili do të ishte mendimi i ARKEP-it, e kryetari i bordit të ARKEP-it është përgjigjur se si rregullator do të ishte ndërhyrje nëse jepet mendim për këtë çështje. Ndërkaq deputeti Armend Zemaj ka thënë se është shqetësues ajo çfarë ka ndodhur në Telekom andaj, sipas tij, ARKEP-it i ka takuar të merret pak më shumë për ndërhyrje, edhe pse shumë institucione përkatëse mbyllën sytë dhe veshët për këto shkelje.

**EPOKA
ERE** Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 11 KORRIK - Në Komisionin Hetimor Parlamentar në lidhje me gjendjen në Telekomin e Kosovës dhe Vala të enjten është intervistuar kryetari i Bordit të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (ARKEP), Kreshnik Gashi, si dëshmitar, të cilit i janë kërkuar sqarime lidhur me licencimin e

operatorëve virtualë, veçanërisht për "Z-Mobile" si dhe për numeracionin e kësaj kompanie nëse nuk ripërtërihet kontrata mes tyre dhe Telekomit. Anëtar i Komisionit, Bekim Haxhiu, e ka pyetur Gashin se deri kur ka licencë së funksionari operatori virtual "Z-Mobile" dhe nëse kjo gjë është e ndërlidhur me licencën e "Telekomit". Po ashtu, Haxhiu ka pyetur edhe për konsumatorët e "Z-Mobile"-s që, nëse mbeten pa shërbime

nga 1 gushti, çfarë do të ndodhë me numra individualë. Kreu i ARKEP-së, Kreshnik Gashi, ka thënë me liberalizmin e tregut të telekomunikimeve elektronike operatorët virtualë nuk janë të obliguar të pajisen me licenca, përveç autorizimeve individuale për frekuencë dhe enumeracion. "Pra, nuk është me rëndësi nëse janë të licencuar, por është me rëndësi se operatorët virtualë a kanë kontratë me një operator tjetër. 'Z-

Haradinaj pret nga PDK-ja që ta sjellë emrin e ri për ministër të Inovacionit dhe Ndërmarrësisë

Prishtinë, 11 korrik - Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë ka mbetur pa ministër qëkur është larguar nga kjo pozitë Besim Beqaj. Për propozimin e ministrit të ri ka folur të enjten kryeministri Ramush Haradinaj, i cili ka thënë se është në pritje të partnerit të koalicionit të PDK-së që ta propozojë emrin e ri se kush do ta zëvendësojë Besim

Beqajn. "Propozimi pritet të vijë nga Partia Demokratike e Kosovës. Kurdo që ata kanë një propozim unë do ta shqyrtoj. Deri më tani nuk ka ndonjë propozim. Unë kam interes për t'i emëruar ministrat edhe për shkak të kuorumit. Sa më shpejt që ndodh do të ishte një gjë e mirë", ka thënë Haradinaj në konferencën e së enjtes pas

mbledhjes së Qeverisë. Më 20 qershor Besim Beqaj është larguar nga posti i ministrit të Inovacionit dhe Ndërmarrësisë me pëlqimin e liderit të PDK-së, Kadri Veseli, i cili ka marrë vendim që të gjithë zyrtarët e kësaj partie që kanë aktakrua t'i lirojnë pozitën në institucionet e Kosovës.

(A. MAVRAJ)



Komuna e Klinës dhe IADK-u mbajtën sesion informues për fermerë

KLINË, 11 KORRIK (ER) - Komuna e Klinës, përkatësisht Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural ka organizuar sesion informues me fermerët e kësaj komune. Ky sesion informues është mbajtur nga organizata joqeveritare Iniciativa për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës (IADK) e cila është duke zbatuar projektin "Mbështetja e zinxhirit të vlerave të BMA përmes krijimit të punësimit të eksportit", përkrahur nga Deutsche Gesellschaft für International Zusammenarbeit (GIZ), mandatuar nga Qeveria e

Republikës Federale të Gjermanisë. Me këtë rast janë ftuar ftohen fermerët e Komunës së Klinës që të aplikojnë për përfitimin e garantëve në sektorin e bimëve mjekësore dhe aromatike.

Drejtori i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Naser Morina, ka inkurajuar të gjithë fermerët si dhe kompanitë të cilat janë të interesuara të merren me kultivimin e bimëve mjekësore dhe aromatike, të aplikojnë dhe të përfitojnë nga përfitimet ekonomike dhe shëndetësore të tyre.



Situata e sigurisë në Malishevë vlerësohet stabile

MALISHEVË, 11 KORRIK (ER) - Komuna e Malishevës vazhdon të jetë një prej vendeve më të qeta dhe më stabile në fushën e sigurisë së përgjithshme, në veçanti në gjashtëmujorin e parë të këtij viti ka rënie të vjedhjeve, por ka edhe rritje të zbulimit të rasteve të veprave penale. Kështu është bërë me dije në mbledhjen e rregullt të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKS), e cila është drejtuar nga kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj.

Gjatë raportimit në këtë mbledhje, komandanti i



Stacionit Policor në Malishevë, kapiteni Azem Krasniqi, ka thënë se në raport me gjashtë-

mujorin e vitit të kaluar gjendja është shumë më e mirë dhe në këtë ka ndikuar vendosja e

kamerave të sigurisë në qytet. Gjatë raportimit dhe krahasimit me gjashtëmujorin e parë të vitit të kaluar, kapiteni Krasniqi ka thënë se ka rënie të rasteve të vjedhjeve, ku nga 34 raste të regjistruara gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2018, këtë vit janë regjistruar vetëm pesë raste. Sipas tij, zbulueshmëria e rasteve është rritur për 20 për qind dhe kjo, sipas Krasniqit, është rezultat i vendosjes së kamerave dhe rritjes së aktiviteteve policore për rreth 20 për qind më shumë.

Sa iu përket shërbimeve emergjente, sipas drejtorit

komunal për Mbrojtje dhe Shpëtim, Valon Gashi, në gjashtëmujorin e parë ka pasur më pak raste emergjente. Sa i përket situatës me EHKK, Gashi ka bërë me dije se është duke vazhduar dezinfektimi i zonave endemike, përkatësisht deri më tani janë dezinfektuar 24 zona të cilat llogariten endemike.

Temë tjetër e diskutuar në këtë mbledhje ishte edhe siguria në shkollat dhe përfundimi i vitit shkollor ku, sipas drejtorit të Arsimit, Blerim Thaçi, siguria në shkollat e Komunës së Malishevës është në nivel të kënaqshëm.

Në Ferizaj diskutohet për zbatimin e të drejtave dhe lirive të fëmijëve

FERIZAJ, 11 KORRIK (ER) - Komuna e Ferizajt ka qenë nikoqire e tryezës së diskutimit me temën "Ligji për mbrojtjen e fëmijëve". Në këtë tryezë të organizuar nga ATRC-ja është diskutuar mbi rregullativën ligjore që mbron fëmijët, promovon dhe kujdeset për zbatimin e të drejtave dhe lirive të fëmijëve.

Pjesëmarrës në këtë tryezë nga pushteti lokal kanë qenë kryesuesja e Kuvendit Komunal të Ferizajt, Kristina Gashi-Bytyçi si dhe drejtori i Drejtorisë së Arsimit, Afrim Llabjani, prokurori i shtetit, Burim Çerkin, përfaqësues nga Policia e Kosovës, Qendra për Punë Sociale, Kuvendi i të Rinjve, Asambleja e Fëmijëve, anëtarë të kuvendit të komunës si dhe organizata të shoqërisë civile. Drejtoria e Arsimit e Ferizajt

muaj më parë ka funksionalizuar Asamblenë e Fëmijëve si mekanizëm institucional për avancimin e kësaj agjende për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të fëmijëve, duke i shtuar këtu edhe Rregulloren Komunale për realizimin e të drejtave të fëmijëve përmes sistemit qeverisës komunal, miqësor për fëmijët.

Mbrojtja dhe promovimi i të drejtave të fëmijëve është pjesë e veçantë e platformës qeverisëse të kryetarit të Ferizajt, Agim Aliu, në kuadër të kujdesit institucional për sigurinë dhe familjen. Diskutuesit në këtë takim, përveç informacioneve që morën për këtë temë, dhanë edhe komentet, sugjerimet dhe vërejtjet për funksionimin institucional për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.



Kryetari i Suharekës paralajmëron gjoba për ndotësit e ambientit



SUHAREKË, 11 KORRIK (ER) - Kryetari i Komunës së Suharekës, Bali Muharremaj, ka bërë me dije se në ditët e ardhshme do të nisin me shqiptimin e gjobave për të gjitha ata që ndotin ambientin në këtë komunë. Muharremaj ka


kërkuar nga qytetarët që mos të hedhin mbeturina në vendet ku është e ndaluar. "Sot sërish po pastrohet rruga nga Suhareka në drejtim të Carralevës. Kërkoj me sinjeritetin më të madh, sidomos nga ata që udhëtojnë në këtë destinacion, të mos

hedhin mbeturina. Ambientin duhet ta ruajmë dhe në këtë proces të vetëdijesimit duhet të bashkëpunojmë edhe me ju. Në ditët në vijim do të pasojnë edhe gjobat për këdo që e dëmton ambientin", ka thënë Muharremaj.

Diplomatët që e shkëlqejnë epokën e bacë Adem Demës, ose për një vepër që është më shumë se diplomaci e më pak se politikë (2)

Diplomati si përfaqësues i UÇK-së pa republikë e pa ambasada klasike

(Sabri Kiçmari, "Fitorja diplomatike: kujtime nga përfaqësuesi diplomatik i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës", "Epoka e re", Prishtinë, 2017)



Prof. dr. Hakif BAJRAMI

Në stilin së pari ishte fjala, Sabri Kiçmari do të takohet si i autorizuar me V. Ishingerin, pastaj do të lëshojë një intervistë si përfaqësues i UÇK-së për gazetën "Der Spiegel", duke u takuar me zëvendësministrin e Jashtëm të Suedisë, duke e vazhduar me informime Parlamentin Evropian, Komisionin Evropian, Parlamentin e Belgjikës, duke kontaktuar miqësisht me Ministrinë e Punëve të Jashtme të Austrisë (Vollfgang Shysel), me ministrin e Jashtëm të Holandës, çdo kund duke dëshmuar seriozitetin dhe dituri civilizuese diplomatike dhe faktografike, që deshëm apo nuk deshëm, e bëjnë edhe "gurin që nuk flet dhe nuk lëvizë, të flas dhe të besojë, sepse fjala vjen nga njeriu i kombit të Bersës, që quhet Sabri Kiçmari me shokë shumë, shumë informata ia kanë ndryshuar rrjedhat historisë Kosovës. Ky fakt ma në fund duhet të dihet.

Në çdo situatë prapë fjala, në rend të parë, duke u njohur dhe duke informuar kompetentët e Gjykatës për Krime lufte në ish-Jugosllavi, sepse nga 4 korriku 1992 Badinteri e kishte shpallur Jugosllavinë shtet inekzistent, lavdia e UÇK-së në këto rrethana do të pasojë zbatimit e baticës, por kurrë Adem Jashari, Zahir Pajaziti, Adrian Krasniqi, Luan Haradini, Agim Ramadani, Sali Çeku, Fehmi Lladrovci, nuk do të dinë të ecin prapa, sepse nëna Shqipëri, oficerët e saj si Tahir Sinani me shokë shumë, i kishin mësuar të marshojnë vetëm drejtë.

Duke plasuar informata në Ministrinë e Jashtëm të Gjermanisë, duke u fokusuar në masakrën e Reçakut, duke mbajtur konferencë informative në Bon, Sabri Kiçmari do të gjendet në Konferencën Ndërkombëtare të Rambujesë, me detyrë speciale të diplomatit "pa republikë".

Sabri Kiçmari e veçon si diplomat pa ambasadë si të suksesshëm konferencën e Rambujesë.

Ky qëndrim është realist vetëm kur shikohet nga brenda. Pse po e themi këtë, në zyrën politike të UÇK-së në Prishtinë, është zhvilluar gjatë janar-shkurtit 1999, një dramë politike: të shkohet apo të mos shkohet në Rambuje.

Ne që ishin njerëz të këshillave, e kishim marrë Bacën (Adem Demën) huqaz që me çdo kusht të shkojë në atë Aeropagë, ku vizatohej virtualisht, na dukej neve, fati i Kosovës. E vërteta tre këshilltarë të Adem Demës e rezervonim mendimin që në Rambuje të shkohet, sepse ata që kishin para dhe 'informata afirmative' i kishin krijuar kushtet të mbulojnë shumë çka me një ngjarje që ishte në shikim të parë atraktive, sepse për Kosovën ishte historike.

Në këtë famë që ishte krijuar në Kosovë se "luftuam nuk luftuam, prapë të mëdhenjtë do të na çlirojnë"! Filozofi kjo mjerane që në vitet 1941-1944, kishte krijuar konfuzion në popull sa që ka pasur raste kur na janë kërcënuar edhe "po doni me na marrë në qafë".

Kuptohet këtë klithje e bënin përmes kafeneve në të cilat nuk ishim si akterë kurrë. Po, Bacën e kishim këshilluar që të shkojë në Rambuje, por mos ta nënshkruaj kapitullimin se: "Sovraniteti i Jugosllavisë mbi Kosovën nuk diskutohet, se në Kosovë mbesin kaq ushtar dhe policë serbian etj?"

Lexojeni qytetarë dokumentin e nënshkruar në origjinal. Pra, nga e zeza në të bardhë, Kosova fitonte famë edhe institucionale edhe individuale në Rambuje, por nuk fitonte liri substanciale shtetformuese, sepse mbetej në gjirin e Serbisë, bile me futë të zeze në kokë kur peshohen viktimat, sepse 10 pika ishin të panegociueshme, e ato ia siguronin Jugosllavisë Zhablakut sovranitetin përmes 11000 ushtarëve dhe policëve serbianë, që do të mbeteshin në Kosovë, që të shpallin orë policore, të vrasin dhe të robërojë tash me garanci ndërkombëtar. Këtu në asnjë variant Bac Adem Dema nuk tundej: 's'ka nënshkrim, 's'ka shkuarje, prandaj është thikë pas shpine për UÇK-në pse jo edhe Bacës që ka bërë 28 vjet luftë nga burgu, sepse ai tas (2019) nuk mundet të flas, por do të flasin dokumentet që do të bëjnë që krisma e pushkëve çlirimtare me plotë sakrificë ma larg të ndihet. Po, Adem Dema e ka pasur të ditur qysh në maj të vitit 1998

nga dora e parë e Bushit Palk (12 vjet shef i CIA-s dhe president famëlartë i ShBA-së që shpalosi vijat e kuqe-hb), Jugosllavia e Zhablakut do të bombardohet, se Baca e ka pasur të njohur qysh në gusht 1998 se në Aviano-qendra e NATO-s në Itali ishin bërë manovra ushtarake provuese, se si do të bombardohet Jugosllavia e Zhablakut; Baca e kishte në njohur se në shtator 1998, cilat caqe të shtetit fashist do të bombardohen. Lexoni qytetarë të Republikës Kosovës dokumentet e CIA-s në origjinal për kongresin e ShBA, të deklasifikuar dhe të botuar, bile edhe në "Koha Ditore" në 40 vazhdime, sidomos vazhdimin X të 4 gushtit 1998.

Botimi i dokumenteve të gjitha rrenave dhe profakteve politike ua zë frymën.

E historia është matematikë, kur prej saj largohet politika dhe interesi i tezgës, kur vihen në tavolinë argumentet.

Pas 23 marsit 1989 vjen 24 marsi 1999

Shumë ngjarje lidhen e pështrihen rreth 24 marsit 1999 si: Vukovari, Dubrovniku, Vushegradi, rrethimi trejeçar i Sararajevës, por asnjëri nuk ka organikushte të bëjë me faktin se pas 23 marsit 1989 të Kosovës vjen 24 marsi 1999 i fillimit të bombardimit të Jugosllavisë Zhablakut, vjen pas dhjetë vitesh, por vjen si triumf i drejtësisë dhe luftës së drejtë, i gjakut të derdhur kudo nëpër vatrata stërgjyshore. Dhe kur jemi këtu a nuk kanë mundur ndonjë ditë tjetër ta shpallin Jugosllavinë inekzistente por më 4 korrik 1992.


E 4 korriku ishte ditë e luftëtarit në Jugosllavinë titiste. E 28 qershori kur u dërgua Milloshi në pranga në Hagë, a nuk ka mundur të jetë një ditë tjetër. Po, por ata që duan të mbesin në histori, janë edhe filozof të saj. Me intervenimin e NATO-s më 24 mars 1999 do të tregohet se qendrat e Fuqisë nuk do ta durojnë ma fashizmin Serbian që të shkaktojë gjenocidin vijues, fakt ky që ndodhi, fakt ky që pretendohet të bëjë model, sepse pas Kosovës sipas dokumenteve sekrete Milloshi e kishte në plan sulmin ndaj Maqedonisë. Por lufta 78 ditëshe e NATO-s dëshmoi edhe një realitet se fashizmi serbian e kishte realizuar Programin që përqindjen 49 për qind shqiptarë e të tjerë, dhe 51 për qind serbian në Kosovë të avancohet si realitet, dhe ata të parët (49 për qind) jo për njëherë por evolutivisht t'i denacionalizojë.

E lufta e UÇK-së dhe bombardimet e NATO-s vërtetuan se plani "Patkoji" nuk zbatohet për herë të parë ndaj shqiptarëve. Ky plan është zbuluar për here të parë nga Shfqete Dergut Pasha më 1910, ndaj shqiptarëve. Ky plan është përsëritur nga Millorad Drashkoviq më 1921 kundër kaçakëve të Azem Galicës; ky plan është aktualizuar më 1951-1966 për shpërnguljen e shqiptarëve në Anadoll nga J. B. Tito, A. Rankoviç, Llukiq, Stefanoviç dhe K. Cervekovski. Patkoji është stërpërsëritur edhe kundër UÇK-së më 1998/99.

Sabri Kiçmari do ta vazhdojë vepërimitarë si i kujtohet në këtë publikim në cilësinë e diplomatit që flet në emër të Kosovës, në luftë, duke lënë gjurmë shpresëdhënëse politike për fatin e vendit,

në Budapest, pasi që kishte këmbyer informata me një diplomat shumë të rafinuar i quajtur Larry Rosse, i cili me disa poltronë shqiptar në çdo etapë e ka drejtuar qerren e Kosovës kah kënetat për ta ngulatur prapë nën thundrën serbo-malazeze, si e njoh dhe si e çmonte Baca Adem Dema, pas çdo takimi.

Duke lexuar librin e prof dr Sabri Kiçmarit, "Fitorja diplomatike", studiuesit i dalin përpara shumë etapa dhe personalitete me të cilët diplomat ynë bisedon në: Bohum, Bon, Gjenevë, Arau (1 tetor 1998), Bruksel, Den Hagë (11 XI 1998), Amsterdam duke i provuar në stilin e ISA Boletinit a janë: Gellbart, Hollbruk, K. Hill për zgjidhjen e çështjes Kosovës, apo janë vetëm llafazan të salloneve. E shtron këtë pyetje në ndërgjegjen e tij, sepse synimi i tij ishte synim i UÇK-ës, si ushtria më serioze në Evropë, që po zhvillonte Neoluftë, e që modelit saj faktorizues filluan t'i frikësohen të gjithë guvernatorët e pushteteve që mbajnë popuj e treva të huaja, nën robëri ende. Në këtë drejtim, më të zëshmet edhe atëherë kundër UÇK-ës ishin: Spanja, India, Rumunia, Brazili, Indonezia, Greqia, Qipro, Irani e sidomos tinzishtë Vatikani. Pse? Lexojeni Konkordatin Vatikani - Principata e Malit Zi 1864; lexojeni Konkordatin Vatikani Mbretëria e Serbisë 1914 dhe pasojat deri më 27 maj 1999. Këtu është një virus me peshë për shëndetin shtetëror të Kosovës. Unë nuk jam faktor se do ta kuptoni kur t'i lexoni se ende "uji vlon në akull", kur janë në pyetje shqiptarët, plus kur janë myslimanë. **(Vijon)**



Votimi për Ursula Von der Leyen më 16 korrik

STRASBURG, 11 KORRIK - Konferenca e presidentëve të Parlamentit Evropian ka vendosur që kandidati i 28 vendeve për Presidencën e

Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, do të votohet më 16 korrik. "Seanca e Parlamentit Evropian do të fillojë të martën, më 16 korrik në

orën 09:00", thanë burime diplomatike në Strasburg. "Ky debat do të vazhdojë deri në orën 12:30. Votimi për zgjedhjen e presidentit të

Komisionit Evropian do të zhvillohet të njëjtën ditë në orën 18:00", thuhet në një shënim të Parlamentit Evropian.



Gara për president të ShBA-së në kampin e demokratëve

Ish-zëvendëspresidenti Joe Biden mbetet kandidati kryesor në mesin e demokratëve për t'ia zënë vendin presidentit Donald Trump vitin e ardhshëm, por ai po përballet me sfida gjithnjë e më të forta nga dy senatore: Kamala Harris e Kalifornisë dhe Elizabeth Warren e shtetit Massachusetts

WASHINGTON, 11 KORRIK - Fushata presidenciale e demokratëve vazhdon të ketë ndryshime, ndërsa një kandidat largohet dhe një tjetër i bashkohet një grupi tashmë të madh, me shpresën për t'i zënë vendin presidentit Donald Trump vitin e ardhshëm. Ish-zëvendëspresidenti Joe Biden mbetet kandidati kryesor në mesin e demokratëve, por ai po përballet me sfida gjithnjë e më të forta nga dy senatore: Kamala Harris e Kalifornisë dhe Elizabeth Warren e shtetit

Massachusetts. Aktivisti liberal, miliarderi Tom Steyer, e shpalli zyrtarisht kandidaturën e tij përmes një videoje. "Nëse mendoni se ka diçka që meriton vërtet të kritikohet, përpiquuni sa të mundeni, por mos u shqetësoni, lëreni ngjarjen të rrjedhë natyrshëm. Pikërisht këtë po bëj unë. Emri im është Tom Steyer dhe kandidoj për president", tha ai. Steyer ka mbështetur prej kohësh idenë që presidenti Donald Trump t'i nënshtrohet procesit që mund ta sjellë

shkarkimin e tij, një çështje për të cilën demokratët e Kongresit vazhdojnë të jenë të përcarë. Por ndërsa Steyer hyri në garë, kongresisti i Kalifornisë, Eric Swalwell, u bë i pari që largohet zyrtarisht nga grupi i demokratëve në garën presidenciale. "Është një grup njerëzish të talentuar dhe kjo ishte një nga sfidat për ne. Kjo është një garë shumë e vështirë dhe ka për t'u ndërlikuar edhe më tepër, prandaj pres me kënaqësi t'i ndjek debatet nga pozita e një qytetari të zakonshëm", tha ai. Swalwell mori pjesë në debatin e parë të transmetuar në rrjetin NBC dhe sulmoi ashpër kandidatin që kryeson garën e demokratëve, Joe Biden. "Joe Biden kishte të drejtë kur tha 32 vjet më parë se ishte koha për ta kaluar pishtarin te një brez i ri amerikanësh. Kjo mbetet e vërtetë edhe sot", tha ai.

Moderatori: "Nënpresident, doni të këndonin një këngë për pishtarin?" Joe Biden: "Po. Unë ende e mbaj atë pishtar". Bideni vazhdon ta udhëheqë garën e demokratëve, megjithëse pati çaste të vështira në debatin e parë. Ish-zëvendëspresidenti tani po përpiket të shmangë sfida të forta nga senatorja e Kalifornisë, Kamala Harris dhe senatorja e Massachusettsit, Elizabeth Warren, të cilat patën një rritje në sondazhe pas debatit. Largimi i Swalwell nga gara është një shenjë që ka filluar procesi i eliminimeve në fushën e demokratëve, thotë analisti Jim Kessler. "Unë mendoj se jemi në pikën ku kemi tetë deri në dhjetë kandidatë, të cilët kanë shanse ta fitojnë emërimin. Në këto debate kemi parë disa prej kandidatëve me më pak mbështetje dhe që

vazhdojnë të jenë të tillë. Ndoshta është momenti të ata të largohen", thotë analisti Kessler. Demokratët nuk e fillojnë procesin e votimit për ta zgjedhur kandidatin e tyre deri në zgjedhjet paraprake të Iowas në shkurt. Kjo është një kohë e mjaftueshme që pretendentët t'i gjejnë defektet e njëri-tjetrit dhe të mbjellin ndarje brenda partisë, thotë analisti Larry Sabato. "A do të jenë ata të gatshëm të mbështesin një kandidat të vetëm në mesin e 20 kandidatëve, i cili do ta marrë emërimin e partisë kur kandidati i tyre të humbasë? Kjo është një provë e madhe për një parti kurdo qoftë dhe përgjigja asnjëherë nuk mund të dihet kaq herët", thotë analisti Sabato. Demokratët e kanë debatin e tyre të ardhshëm në Detroit në fund të këtij muaji.



Putini i gatshëm ta takojë udhëheqësin e ri të Ukrainës

MOSKË, 11 KORRIK - Presidenti rus Vladimir Putin thotë se është gati të takohet me presidentin e ri të Ukrainës për të negociuar që t'i jepet fund konfliktit vdekjeprurës midis dy vendeve fqinjë. Njoftimi i së enjtes i Putinit erdhi si përgjigje e ofertës së presidentit ukrainas Volodimir Zelenskiyt për të mbajtur bised-

ime me udhëheqësin rus, ndërsa Britania, Franca, Gjermania dhe Shtetet e Bashkuara të jenë në funksionin e ndërmjetësit. Putini tha, megjithatë, se bisedimet e propozuara nuk ka gjasa të mbahen para se Ukraina të zgjedhë një parlament të ri muajin e ardhshëm. Pas zgjedhjes në muajin maj, Volodimir Zelenskiyt u zotua t'i

japë fund konfliktit në Ukrainën Lindore, që u ka marrë jetën më shumë se 13 000 njerëzve që nga viti 2014. Marrëdhëniet mes të dy vendeve u keqësuan ndjeshëm kur Rusia aneksoi Gadishullin e Krimesë në vitin 2014 dhe mbështeti separatistët e armatosur në rajonin Donbass të Ukrainës Lindore.



ËNDRRAT E KUQE



Sabile KEÇMEZI-Basha

Kishte vite që nuk ishim dëgjuar e takuar me Zanën, por jo me dashjen tonë. Në mes meje dhe saj kaherë ishte rrënjësuar një miqësi e madhe dhe për një kohë të shkurtër kishte ndodhur gjithçka në Vendin e Shqipeve... dhe pastaj kishte pasur një ndarje përdëlltare në mes nesh. Vitet kishin kaluar dhe ishin bërë stivë duke u thinjur tej mase nga malli. Koha kishte mbështjell lëmsh në grykë fjalët e pathëna, pa mundur ta gëlltitë tërë dufin e viteve të ndarjes. Nëpër kohë kisha ecur si një somnambulë dhe kisha vrapuar këmbëzbathur me shputat e djegura nga dielli që përcëllonte e griste lëkurën e mëmës-tokë në mënyrën më barbare. Me dalmate të bardhë gjerë në fund të këmbëve kisha vrapuar pas kipcit tim, duke i kërkuar fërkemet e vogëlisë që kishin ngelur në sokakët e baltosura atje... tej... diku... nuk e dija se ku... dhe fshiheshin rrengshorshëm në mjegullnajën pas hijeve që kishin vazhduar për ta lozur lojën vegulli pas vegullie me flakën e dragoit në buzë. Në shtatin tim të lodhur si dëshmi koha kishte bërë tatuazhe - harta të llojlojshme të vatanit, të përgjakura nga katedralët e çmendur, në lëkurën

time flamur.

- Një jetë është pak për ta realizuar ëndrrën... - më thoshte babai.

- E ëndrrat... çfarë janë ëndrrat për ty babi? E kisha pyetur një herë me sy të picërruar nga frika, se ç'përgjigje do të merrja.

- Ëndrra të kuqe... vazhdimisht kam parë, ëndrra të kuqe... - më thoshte ai i menduar. Dhe... vazhdonte që të murmuriste më tepër për vete sesa për mua... dhe shtonte...

- Edhe babai im, kishte parë të njëjtat ëndrra. Dhe, ashtu shtruar fillonte që të zhvillonte historinë, e unë nga një kënd i odës përcillja atë flakë të kuqe që dilte hove-hove nga drithërima e zërit të tij të mekur. Herë-herë frikësohesha nga këto tregime me ëndrra të kuqe, e herë-herë hezitjoja t'i tregoja se edhe unë kam ca ëndrra... Por, nuk ia thosha dot... nuk e di pse nuk ia thosha, frikësohesha apo nuk doja ta ngarkoja edhe më tepër për të njëjtin mllef që mbaja njësoj si ai... Çfarë ishte ëndrra e ime??? Njësoj e kuqe... njësojë e rëndë dhe njësojë e plagosur...

Babai i kuptonte mëdyshjet e mia dhe më thoshte... por unë, edhe tani, pas sa e sa viteve nuk e kam të qartë pse më thoshte... Iu dhimbsha... frikësohej dhe tmerrohej nga vazhdimësia e dhembjes, dhe trandej nga mendimet për të vazhduar:

- Mos u merakos... kot... se ëndrrat nuk trashëgohen... por ëndrrat e kuqe... hem... gjithsesi... janë si amaneti... Nuk të shqitën fare po s'u realizuan, e shtrenjta ime, -kështu më thërriste nga

dashuria e madhe që ndiente për mua... babai im.

E unë, edhe më tej tentoja ta merrja lidhjen me Zanën. Dhe përsëri nuk e merrja... nuk e merrja, assesi!!! Sa e bezdisshme më dukej kjo ditë. Telefoni cingëronte vajtueshëm... E në anën e kundërt të telit, nuk ishte askush për ta ngritur. Kështu ky telefon i grymët ka cingëruar për dyzetë... pesëdhjetë... e fiu ... vite me radhë, dhe ... më ka grisur ëndrrën e blertë, në miliona copë-copë... Në grimca të vogla e në copëza pak më të mëdha që më kishin handakosur ditën. E babai, edhe më tej më fliste se ëndrrat nuk trashëgohen... Unë në heshtjen sflitëse, nuk i besoja më as një fije... dhe më asnjë fjalë... Zot, si humbet besimi te njerëzit që aq shumë i do e kjo më trishtonte tej mase. Thellë... thellë në vete, e dija se nuk isha e drejt me babanë, babanë tim të mrekullueshëm.

Muri makabër e kishte rrethuar kalanë time prej guri dhe ushtarët me kaska prej stralli, të radhitur palë-palë, mbronin Vendin e Shqipeve!!! E nga kush e mbronin vallë? Korbata e shumëzuara për dhjetë, njëqind e një mijë krakëllinin livadheve të blerta, për ta sforcuar Hadin me ligjet e tij. Shpesh më buçiste koka nga dhembjet e padurueshme që sillnin stinët migrenoze. Letrat e zverdhura nga vitet që vinin rrallë e më rrallë, nga Zana, i lexoja në dritën e hënës, dhe me vite-dritë kishin ngelur pa përgjigje. Në Vendin e Shqipeve, edhe më tej jetonim për çdo natë, tok... në

beteja, korbat e pulëbardhat, pulëbardhat e korbat, në një ishull. Dhe, për çdo ditë të lume, nata e Shën Bartolomeut na u rritte si thoi në gishta dhe ne, edhe më tej e mbanim mbi gjymtyrë të lodhura. Kafkat e shkallmuara nga vitet e humbura, i sillte përroi vërshues dhe qanin pandërprerë për çikën që kurrë nuk u bë nuse. Ehu... ku mbeti duvaku i nusësisë, vallë? Ku mbeti duvaku i kuq... Ku mbeti duvaku i zi... Apo, unë më kot e kisha sajuar nëpër shekuj... hartën e atdheut.

- Sa vështirë merret kjo lidhje telefonike!... Sa pështirë... Ngrite atë kufje të mallkuar, bërtita, si e luajtur mendsh. A nuk po e sheh, se mbi qepallat e mia mbronin dhembja e stërlashtë. Samari me kujtime ecën rëndë në tri këmbë të çala, si vetë pritja në zenit e ditës së ardhur. Sa e kuqe është dita me dritë në trojet e Shqipes.

- Unë të shoh... të hetoj... edhe kur ke dhembje... edhe kur ke gjëmë e mall... - më thoshte babai. Sa shumë më ngjanë... murmuriste ndër dhembje... duke më shikuar drejt në sy. Sytë... sa të zinj i ke sytë Martinë, sy të mëdhenj dhe të befasuar ke... dhe kolli edhe një herë për ta pastruar fytin e tharë. Fliste babai im duke shtuar, e di ti Martinë, se në kasollen time me tre mure qëndron ende e varur në kornizë, harta e zverdhur e atdheut, pa anatominë e saj, pa dashje më ankohej babai. Ti buzëqesh, epo... ç' thua ti, Martinë, po mos të ishte qeshja jote, çfarë emri do t'i

jepja dashurisë dhe mallit.

- Alo, alo... - dëgjohej zëri tej amplitudave të heshtjes.

- Martinë... Martinë... si nuk më njeh zërin Martinë... dhe lidhja, trak... këputet... Ç'është kjo melodi Ravelliane?... Ç'është kjo Bolero magjepse që më vjen e paftuar në pritjen time. E në dritën e hënës ende shkruajmë mesazhe me tri të panjohura, unë e babai për të mos i kuptuar rojat e natës - Telefoni përsëri cingëron... - dhe, përsëri mu kujtua...

- Të kujtohet se ç'më pate thënë në ndarje, Babi, se, gjithsesi do të takohemi një ditë të vonuar në Kalë të Konstandinit. Më pate thënë se në Kullat e atdheut do të më përcjellësh nuse... me flamur valëvitur...

- Baba, nuk të besoj më... nuk të besoj baba, se vetë më pate thënë "ëndrrat nuk trashëgohen, Martinë!!!

- Lajmërohu, të thashë... mbrëmë... edhe dje... edhe një ditë tjetër... Kudo që je, bëje një hap prej titani, se ëndrrat e kuqe më lënduan stinën.

- Alo... alo... a dëgjon Martinë, jehoi zëri si ushtimë bjeshke e Alpeve të Shqipeve, dhe qeshja e përvajshme theu terrin...

- Oh... Motër... më në fund... Në dy cepat e globit u shtrinë për tokë ushtaret me uniforma blu dhe ne, të zënë në gëzimim e shpifur, qeshëm si dy fëmijë pa fëmijëri, pa thënë asnjë fjalë... asnjë.



E rrallë

Ajsbergu më i madh në botë është në lëvizje

Kanë kaluar dy vjet qëkur blloku i akullit i njohur si A68 u shkëput nga Antarktida. Dhe satelitët kanë treguar se ajsbergu më i madh në botë po lëviz në ujërat e Weddell Sea dhe tani po shkon në veri përgjatë Gadishullit të Kontinentit të Bardhë. Për njëfarë kohe, dukej sikur masa e ngrirë prej 160 kilometrash ishte e mbërthyer në një pjesë të cekët të detit.




FOTO E DITES



Një fëmijë palestinez shihet duke tërhequr një karrocë të ngarkuar me shishe me ujë në shiritin jugor të Gazës. /AFP/

E jashtëzakonshme

Gjyshes i kthehet portofoli i vjedhur 75 vjet më parë

Kur ta vjedhin portofolin, ndoshta nuk pret të marrësh përsëri mbrapsht, sidomos pas 75 vjetësh. Betty Sissom mori dhuratën e jetës javën e kaluar pasi kuleta e saj që i humbi rreth viteve 1940 u kthye tek ajo. Kuleta e 89-vjeçares u zbulua në një mur të banjës së shkollës së



mesme, së bashku me disa kuleta të tjera. Ajo u gjet gjatë punimeve për kthimin e shkollës së mesme Centralia në një kishë.

BARSOLETA E DITËS



Një bionde shkoi te doktori:
- Doktor, dëgjoj zëra, por nuk shoh askënd.
Doktori:
- Kur të ndodhë kështu?
Biondja:
- Sa herë që flas në telefon.



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Ne ora 16:00 (vikendit ne ora 14:00 dhe 16:00)
"THE SECRET LIFE OF PETS 2" 3D

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 ore 26 min
Rolet: Kevin Hart, Tiffany Haddish, Harrison Ford, Patton Oswalt, Eric Stonestreet, Jenny Slate, Lake Bell, Hannibal Buress, Nick Kroll, Dana Carvey, Ellie Kemper, Pete Holmes, Garth Jennings, Bobby Moynihan
Regjia: Chris Renaud and Jonathan Del Val



Ne ora 18:00
"X-Men; Dark Phoenix"

Aksion/Aventurë/Sci-Fi; 1 orë 53 min

Rolet: James McAvoy, Michael Fassbender, Jennifer Lawrence, Nicholas Hoult, Sophie Turner, Tye Sheridan, Alexandra Shipp, Kodi Smit-McPhee, Evan Peters, and Jessica Chastain
Regjia: Simon Kinberg

Në ora 20:00

"MEN IN BLACK; INTERNATIONAL" 3D,

Aksion/Komedi/Sci-Fi; 1 orë 55 min

Rolet: Chris Hemsworth, Tessa Thompson, Kumail Nanjiani, Rebecca Ferguson, Rafe Spall, Laurent Bourgeois, Larry Bourgeois, Emma Thompson, Liam Neeson
Regjia: F. Gary Gray



Ne ora 22:00

"M A"

Horror/Triller; 1 ore 39 min

Rolet: Octavia Spencer, Juliette Lewis, Diana Silvers, Luke Evans, McKaley Miller, Missi Pyle, Corey Fogelmanis, Gianni Paolo, Dante Brown

Regjia: Tate Taylor



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe **boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**

 <p>DASHI Keni marrë përsipër shumë aktivitete njëherësh. Nuk do ta përfundoni asnjërën prej tyre sepse ngarkesa do të jetë e madhe.</p>	 <p>DEMI Një situatë e komplikuar mes kolegësh sot do të marrë një drejtim tjetër. Nëse rrezikoni bashkëpunimin në fund do t'ju fajësojnë juve.</p>	 <p>BINJAKËT Sot duhet të thoni një fjalë të mirë për një person që ju e njihni mjaft mirë dhe që sot do ta kërkojë ndihmën tuaj.</p>	 <p>GAFORRJA Nuk do mund t'i realizoni sot objektivat tuaja nëse nuk e ndani që në mëngjes programin e ditës. Çdo e papritur penalizon finalizimin e punës.</p>	 <p>LUANI Një gënjeshtër që ju kanë thënë do të vazhdojë të thellohet edhe më shumë. Kujdes me personat që mbani pranë vetes.</p>	 <p>VIRGJËRËSHA Raportet personale nuk duhet të ndikojnë në ato profesionale sepse do ta prishni punën tuaj. Një çështje delikate ka zënë ditën tuaj sot.</p>
 <p>PESHORJA Surpriza për ditën e sotme do të jetë takimi me një mik që kishit kohë pa e parë. Do të shikoni që koha ka ndaluar dhe këshillat e tij janë gjithmonë të vlefshme.</p>	 <p>AKREPI Keni limitet tuaja në fusha të caktuara dhe do të jetë mirë ta pranoni këtë gjë. Nuk ka asnjë problem nëse kërkon ndihmë kur e shihni të nevojshme.</p>	 <p>SHIGJETARI I keni zgjedhur mjaft mirë kundërshtarët tuaj dhe do të arrini t'i manipuloni deri në çastin që e quani të arsyeshme.</p>	 <p>BRICJAPI Po keqkuptoni afrimin e dikujt sot dhe do t'ju duket sikur ka ide të tjera nga ato që ju ka shprehur. Do të kuptoni me kohë se keni gabuar.</p>	 <p>UJORI Herë pas here keni brejtje ndërgjegjeje për veprimet që keni bërë në të kaluarën. Keni kohë për t'i rregulluar situatat nëse i viheni punës.</p>	 <p>PESHQIT Dita do të ketë mjaft lëvizshmëri sa në një çast të caktuar do t'i harroni prioritetet tuaja. Një familjar do të mërzitet nga kjo neglizhencë.</p>

Ariana Grande thotë se nuk e njohu ish të fejuarin



Ariana Grande ka bërë një koment të rrallë publik për marrëdhënien e saj me ish të fejuarin Pete Davidson. Në një intervistë për "Vogue", Ariana thotë se u takuan pasi miqtë e bindën atë të shkonte në Nju Jork për një verë. "Miqtë e mi më thanë eja sepse do


të kemi një verë argëtuese. Dhe pastaj takova Pete. Unë e doja dhe nuk e njihja", ka thënë ajo. Ariana Grande dhe Pete Davidson u fejuan vetëm disa javë pasi filluan të takoheshin në maj të vitit 2018, por marrëdhënia e tyre përfundoi në tetor.

Adriana Lima në lidhje me një turk?



Në fillim të këtij viti supermodelja Adriana Lima ka njoftuar për ndarjen nga partneri i saj, Metin Hara. 38-vjeçarja dhe shkrimtari turk u panë për herë të parë bashkë në korrik të vitit 2017. Por tashmë gjashtë muaj pas ndarjes, Lima duket se e ka lënë pas marrëdhënien me të, për të qenë në krahët e një biznesmeni, sërish turk. Bëhet fjalë

për Emir Uyar, pronari i një rrjeti të njohur hotelesh luksoze. Ata janë parë teksa nisin pushimet gjatë fundjavës, në qytetin e Venecias e për të vazhduar më tej në destinacionin e preferuar të modelueses, Mykonos. Lima dhe Uyar janë fotografuar të kapur për dore dhe tepër të lumtur në krahët e njëri-tjetrit tekta eksploronin ishullin.



Alex i qëndron prapa Jenniferit edhe në kohë të vështira

Alex Rodriguez po qëndron i fortë për të fejuarën e tij, Jennifer Lopez. Këngëtarja 50-vjeçare pranoi se kishte probleme me performancën e saj live në "It's My Party". Ajo shpesh

shkoi në prapaskenë dhe aty mori shumë përkrahje nga Alexi. Pas përfaqimit dhe puthjes së saj, Rodriguezi siguroi Lopezin se ajo natë ishte shfaqja më e mirë që ka parë deri më tani.

Jahti luksoz ku Dele Ali vazhdon pushimet



Ndërkohë që ekipet e tjera janë duke djegur kaloritë që kanë marrë gjatë verës, Dele Ali vazhdon të qëndrojë në San Trope, në jahtin luksoz që e paguan 42 mijë euro në javë. Ali është parë me të dashurën e tij, Rubi Mae, me pushimet që kushtojnë

vetëm një pjesë të rrogës 110 mijë euro në javë. Jahti ka tri dhoma, një suitë personale, si dhe një tryezë pokeri që mund të shfrytëzohet mbrëmjeve. Kuverta ka një vend të rehatshëm pushimi, ku mund të marrin rreze dielli e të presin shërbimin e stafit.

romaneve të Kadaresë, Pashkut, Rrahmanit dhe Shkrelit thekson se te Kadareja kemi historinë si ngjarje, çastet e njohura historike vendimtare dhe personalitetet e saj. Te Pashku (kemi) historinë si temë të personazhit. Zejnullah Rrahmani merr një vatër të ekzistencës në aspektin imagjinar, te Kraja intelektualin shkrimtar në procesin historik si fryt i historisë, kurse te Shkreli përpjekjen për kuptimin real të historisë. Pra, historia brenda letërsisë mund të dalë në disa forma, si një realitet i bazuar në fakte historike, pra te romanet historike, si vepër në esencë fikcionale, por që baza e tij është realiteti, një vepër letrare që ka ngjarje fikcionale, por që personazhet i ka realë si dhe një histori e vërtetë nga e kaluar, por që personazhet e saj janë fiktivë.

Zhvillimi i shkencës së historisë ndërlidhet doemos me zhvillimin e arsimit dhe zhvillimi i këtij të fundit doemos ndërlidhet me zhvillimet politike e sociale të një shteti. Duke njohur të kaluarën e shqiptarëve shohim se zhvillimi i arsimit ishte gjithmonë në shkallë të ulët. Dihet mirëfilli se shkolla e parë shqipe ende s'ka mbushur një shekull e gjysmë. Duke u nisur nga kjo nënkuptohet se edhe shkenca e letërsisë është e vonuar. Mungesa e një akademie ose universiteti i cili do të merrej me studime serioze të historisë, populli gjeti zgjidhjen e mësimit të historisë përmes letërsisë, kryesisht përmes këngëve historike. Mungesa e fakteve historike gjithsesi letërsisë ia dhuron atributin e mësuesit të historisë. Këto këngë me kalimin e kohës do të marrin atributin e një të vërtete historike. Në lidhje me këtë edhe Fuko mendon se edhe në diskursin fikcional mund të mbretërojë synimi për të vërtetën. Pra, Fuko e di fuqinë e një vepre letrare te populli, i cili, duke anashkaluar mësime kanonike të historisë, i lë ato anash, duke mësuar historinë e një të kaluarë të afërt apo edhe të largët përmes veprave letrare, edhe pse në të shumtën e rasteve ato janë ngjarje e persona të imagjinuar nga autori sesa ngjarje që në të vërtetë kanë ndodhur dikur a diku. Ndodh shpesh që autorët që kanë më shumë autoritet në popull dhe që bartin një bagazh të madh akademik krijojnë botën e tyre fikcionale për një periudhë të caktuar historike, që përmes saj t'i bartin mesazhet e fshehura të një ideologjie të caktuar, që më pas në ndërdijen e masës së gjerë të krijohet ajo si një e vërtetë historike. Pra, këtu mund të ndeshemi me një problem tjetër brenda tekstit letrar, me atë që ka të bëjë

me bartjen e ideologjisë brenda letërsisë, e që potencialisht mund të krijojë letërsinë ideologjike dhe dogmatike. Kufiri mes letërsisë dhe historisë kurrë njëherë s'ka qenë kufi definitiv. Shpeshherë kufiri mes këtyre dy dijeve humane ka qenë fare pak i dallueshëm. Vepra "Historia e Skënderbeut" e humanistit Marin Barleti dëshmon më së miri këtë pohim. Në këtë vepër, që nga studiuesit konsiderohet vepër e parë e letërsisë shqipe dokumentare, nuk mund të dallojmë se ku mbaron historia e ku fillon letërsia dhe se ku është fakti e ku është fikcioni. Në lidhje me këtë, studiuesi Peter G. Bietenholz thekson se historianët duhet ta kuptojnë se nuk mund ta reprodukojnë se çfarë ka ndodhur në të vërtetë. Ata vetëm mund ta krijojnë iluzionin letrar të realitetit të mëhershëm. Gjithmonë nisur nga ky pohim, theksojmë se historia, konkretisht ngjarjet historike, janë vetëm një shpjegim letrar i realitetit por, ndoshta, jo gjithmonë shpjegim artistik, duke pasur parasysh ligjet e së bukurës. Studiues të shumtë letërsinë e shohim vetëm si variacion i letërsisë. Këtë studiues e ndërlidhin me atë se historia, e veçanërisht historia e popujve me të kaluar të afërt konfliktuale dhe diktatoriale, nuk ka arritur dot të shkëputet nga nacionalizmi dhe animet ideologjike qofshin ato politike, racore a religjioze.

(Marrë nga numri i pestë i revistës "Akademia")

Literatura

Aristoteli, Poetika, Rilindja, Prishtinë, 1984
 Gennete, Gerard, Fiction and diction, Cornell University Press, London, 1991
 Grup autorësh, Çështje të romanit (eseja: romani dhe e vërteta), Rilindja, Prishtinë, 1980
 Hutcheon, Linda, Poetika e post-modernizmit, Om, Prishtinë, 2013
 Krasniqi, Nysret, Histori e letërsi nacionale, AIKD-99, Prishtinë, 2018
 Macleay, Ross, The philosophy of fiction, Bellingen NSW, Australia, 1999
 Platoni, Republika, Phoenix, Tiranë, 1999
 Qosja, Rexhep, Bijtë e askujt: II, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 2010
 Rugova, Ibrahim, Kritika, ASHAK, Prishtinë, 2007
 The Johns Hopkins University Press, New Literary History, Vol 29, No. 4. Critics without Schools?, Baltimore, Maryland
 Uçi, Alfred, Probleme të estetikës, Rilindja, Prishtinë, 1980
 Zhenet, Zherar, Figura, Rilindja, Prishtinë, 1985



LEONARD COHEN

Leonard Cohen (1934-2016), poet, romancier, kompozitor këngësh dhe këngëtar. Karriera e tij letrare filloi në vitin 1956 kur botoi përmbledhjen e parë me poezi të titulluar Let Us Compare Mythologies. Derisa ishte gjallë ka botuar dhjetë përmbledhje me poezi dhe dy romane. Pas vdekjes i është botuar edhe përmbledhja The Flame: Poems Notebooks Lyrics Drawings. Albumin e parë e ka incizuar në vitin 1967 dhe deri në vitin 2016 Cohen ka edituar edhe 14 albume. Gjatë karrierës së tij ka qenë i nderuar me shumë çmime, ndërsa në vitin 2011 ka fituar çmimin prestigjioz për letërsi "Princi Asturias".

PSE E DUA FRANCËN

Oj Francë, ti ua dhe gjuhën tënde fëmijëve të mi, ndërsa dashnorët tu dhe kërpuhat tua gruas sime. Ti i këndove këngët e mia. Ti ua dorëzove nazistëve xhaxhanë tim dhe hallën time. Hasa në gjoksore lëkure të policisë në Place de la Bastille. Mora para nga komunistët. Ua dhashë mesomoshën time qyteteve qumështore të Luberonit. Ika nga qentë e fermës në një rrugë jashtë Rousillonit. Dora më dridhet në tokën e Francës. Erdha te ti me një filozofi të zvetënuar të shenjtërisë, ndërsa ti kërkonte të ulem për një intervistë.

Oj Francë, ku më morën aq seriozisht, më duhej të rishqyrtoja pozicionin tim.
Oj Francë, çdo Mesi i vogël të falënderon për vetminë e tij. Dua të jem diku tjetër; por jam gjithmonë në Francë. Ji e fortë, ji bërthamore, Franca ime. Fliro me të gjitha palët, dhe fol, fol dhe kurrë mos pusho së foluri se si të jetosh pa Zot.

ASNJEHERË

India është e mbushur me shumë gra jashtëzakonisht të bukura që nuk më dëshirojnë unë e verifikoj këtë çdo ditë kur shëtis nëpër qytetin e Bombajit i shikoj në fytyrë njëzën pas tjetrës dhe asnjëherë nuk kam gabuar

BILE EDHE TASH

Nuk e dija sa e thjeshtë je sa bujare u përpoqa të të kapja me rima dhe sugjerime erotike

bile edhe tash ti gogësin në zemrën time e mërzitur dhe e vetmuar duke fërkuar vajrat në krejt trupin tënd dhe duke prekur veten derisa unë vonohem
HILEQARI

Unë bëj hile kur bëj dashuri Ajo mendon se kjo gjë është e mrekullueshme Ajo më tregon gjëra që ju do t'ia tregonit
sall një hileqari

SHELBUESI IM

Mendoj për ty gjatë gjithë kohës Por nuk mund të flas për ty më Më duhet të të dua fshehurazi Më duhet të vij te ti kur jam vetëm Siç jam tash Bile edhe tash më duhet të jem i kujdesshëm I dua të gjitha gratë Që ke krijuar në imazhin tënd Kjo është arsyeja pse i ul sytë Kur i kaloj në rrugë Ti mund ta dëgjosh atë lutjen time Për të cilën nuk kam fjalë Emrin që nuk mund ta shqiptoj Jam i përdredhur nga dashuria Po digjem me mërzi E urrëj maskimin tim Maskën e përgjërimit Ama çfarë mund të bëj Pa maskimin tim Nuk do të krijohesha Shëlbuesi im është femër Fotografia e saj ka humbur Ne e dorëzuam atë Para njëqind vjetësh "Na jepni zonjën", ata thanë. "Është shumë e rrezikshme tash Të kesh shëmbëllimin e saj në mur". Kështu që hoqa dorë prej saj Dhe bashkë me të edhe prej gjuhës Gjuhës së lumtur Që ajo e shpiku për emrin e saj Dhe kushdo që dëshiron Të flasë për të Duhet të bëhet si unë I turpëruar dhe i heshtur I përdredhur nga dashuria Një specialist në mërzitje Dhe çështje të tjera fëmijërore

(Përktheu nga anglishtja: Fadil Bajraj.
 Marrë nga numri i pestë i revistës "Akademia")

Zbulohet për herë të parë fjali

Aurenc BEBJA, Francë
03 / 08 / 2016

Fjalimi i më poshtëm është marrë nga libri i autorit Stephan Zannowich, me titullin « Le Grand Castriot d'Albanie, Histoire ». Teksti prej 131 faqesh është botuar në vitin 1779 nga shtëpia botuese J.J.Kesler, Frankfurt. Gjergj Kastrioti, i sëmurë, nuk mund ti shmangej vdekjes dhe për këtë arsye fton në vatrën e tij princat, ambasadorët, gjeneralët, dhe drejtuesit kryesorë të vendit që tu lë amanetet e fundit ashtu siç i ka hije një luftëtari të madh. Para se heroi ynë të fillonte fjalimin, urdhëron që djali i tij i vetëm, Gjon, asokohe dhjetë vjeç, të ndodhej mes të ftuarve. Fjalimin e Princit të Matit dhe mbretit të shqiptarëve e gjejmë në faqet 70 – 89 të librit, i shkruar në gjuhën frënge. Sipas autorit të veprës, ja si është shprehur Gjergj Kastrioti:

« Jam në prag të varrit. Po ju lë një mbretëri me forca të afta për ta mbrojtur, por me një pasardhës të paaftë nga mosha për ta drejtuar. Megjithatë, në qoftë se në të ardhmen ju bëheni trima dhe të virtyshëm, ju mund të përballoni të gjitha sulmet e armiqve tuaj. Nuk është sipërfaqja e vendit ajo që bën një fron të respektueshëm, por aftësia e atij që ullet mbi të. Në qoftë se ju jeni i djallëzuar, shërbëtor i ministrave tuaj, dhe naiv i lajkave të oborrtarëve tuaj, atëherë asgjë nuk do të jetë më e lehtë sesa përmbysja nga maja më e lartë ku ju ndodheni. Duhet të jetë virtyti themel i fronit. Virtyti nuk është fantazi. Ndoshta do ju a thonë një ditë, por mos harroni se ai që do ju a thotë, është një tradhtar, një dinak, që për të mbretëruar në vendin tuaj, do ju sugjerojë maksima të rreme, të cilat herët a vonë do të shkaktojnë përmbysjen tuaj. Duke pasur virtytin si udhërrëfyes, lajkatarët dhe të pabesët do të largohen prej jush...Të virtyshëm, ju mund të mbani lehtë perandorinë që po ju lë të tronditur nga lufta e vazhdueshme ; ta përforconi, ta rimëkëmbni nëpërmjet pushimit dhe qetësisë...

Krijoni vendshkrime të paçensuruara në të gjithë sipërfaqen e mbretërisë ku mund të publikohen të gjitha padrejtësitë dhe dhuna që mund të ushtrohen nga drejtuesit e krahinave tuaja. Bëni këtë edhe për miqtë apo familjarët e tyre që

jetojnë në oborrin tuaj, të cilët i fshehin këto shkelje apo i përdorin nën pretekstin e drejtësisë dhe të domosdoshmërisë. Shqyrtoni gjithçka nga ju vetë, dhe nëse magjistrati, ushtari apo kleriku janë mashtruesë dhe të padrejtë, atëherë pa mëshirë varini në shtyllë në vendin e krimit : ju do të vini re se pasardhësi i tij do të bëhet i drejtë dhe i njerëzishëm...Kur sapo të keni marrë drejtimin e pushtetit, ju do të kujdeseni për Drejtësinë, e cila është themeli i të gjitha virtytëve. Ju do të mbronni artizanët, si njerëzit më të dobishëm të zonave të pushtetit tuaj, dhe do të parandaloni shtypjen e tyre nga pasanikët. Krenaria dhe lluksi i bën pasanikët të pandjeshëm ndaj fatkeqësive të varfërve, të cilët nuk kanë as tituj (grada) e as mbështetje. Duhet të jeni të butë dhe të dashur me njerëzit tuaj ; dukuni shpesh mes tyre, bisedoni me ta, pyesni ata nëse dëshirojnë tuaj për drejtësi janë ekzekutuar nga ministrat tuaj. Princi që qëndron i mbyllur me oborrtarët e tij shikohet nga populli i tij si armik dhe tiran...Dëgjoni ankesat dhe kërkesat e popullit tuaj me qetësi sa që ti frymëzoni besim atij për t'ju ndihmuar të kor-

rigjoni abuzimet dhe fatkeqësitë e shtetit.

Kujdesuni që Kombi juaj të rritet nëpërmjet fesë katolike, por mos persekutoni asnjëri që ta ndjekë atë me detyrim. Dielli, që është shëmbëllimi i Perëndisë, shkëlqen pa dallim për turkun ashtu si për të krishterin. Kushdo që këshillon për të luftuar për hir të Perëndisë është një mashtrues i cili dëshiron të sakrifikojë të vërtetën për interesat e tij. Zoti është i fuqishëm, ai mund të bëjë gjithçka vetë, pa ndihmën e askujt...Në qoftë se fati ju bën endacak, të varfër apo nevojtar kurrë mos e ndryshoni fenë për interes...Mbyllini që në origjinë mosmarrveshjet e teologëve dhe hipokritëve, të cilat janë më të rrezikshmet për lumturinë e një shteti. Kemi parë perandoritë më të lulëzuara të përçahen dhe të tronditen nga këta fanatikë...Shihni Perandorinë e Konstandinit të rrënuar nga Muhamedi, dhe princin Jean Paléologue (Gjon Paleologu) i shkelur nga kuajt e Arabëve. Ai ishte supersticioz, priftërinjtë e tij ambiciozë dhe injorantë, oborrtarët e tij të rremë dhe të shturur nga lluksi, dhe tani princi, priftërinjtë dhe obor-

rtarët kanë vdekur dhe po vdesin në skllavëri.

Nëse keni fat të mjaftueshëm për të pasur filozofë në vendqeverisjet tuaja, të cilët janë të ndriçuar nga drita e arsyes dhe jo nga sistemet e rreme, le të shkruajnë në paqe dhe të reagojnë ndaj paragjytimeve dhe makinacioneve të kujtdo që flet në emër të Zotit me qëllim për të heshtur mbretin dhe drejtësinë. Ju do t'i mbronni ata kundra zellit të tepruar të drejtuesve hipokritë duke i shpërblyer me vende pune në gjykatat dhe oborret tuaja. Kur të ju flasin keq për dikë, ju do ta dëgjoni me gjysëm veshi... Ju do të jeni të sjellshëm me të gjithë shtresat popullore. Si arsye e dallimit të gradës që do të keni së shpejti në shoqëri, ju duhet të dalloheni nga të tjerët nëpërmjet bujarisë, i cili është karakteri dallues i princave. Një monark, edhe i varfër, duhet të jetë bujar...

Mbroni meritën dhe shpërblejeni atë kudo që ajo ndodhet. Mirësia duhet të shoqërohet me një zemër bujare. Njeriu ndërton tempuj, ngre altarë për Zotin falë mirësisë së tij. Evitoni për gjithmonë shekullit, rrethit dhe rracës tuaj turpin për të pasur njerëz të dëshpëruar nga mizoria, krenaria apo injoranca juaj. Mos harroni se njeriu lind për lumturinë e njëri-tjetrit...

Armatosuni nga guximi dhe vendosmëria në mjerim, me maturi në mirëqenie. Mos u zhytuni në përtaci, ajo është nëna e të gjitha veseve...Mos mbyllni sytë ndaj fqinjëve dhe traktateve të tyre : ata do të presin momentin kur ju do të jeni të brishtë për t'ju akuzuar dhe do të pohojnë pretendime të rreme mbi trashgiminë që po ju lë. Mos përdorni spiunë për të ditur se çfarë thonë njerëzit në lidhje me administrimin tuaj. Bëni punën tuaj ashtu si duhet, njerëzia le të flasin dhe të shkruajnë çfarë të dëshirojnë...

Ti jepet mundësia gjithsecilit prej rrethit tuaj që të ju shkruajë ; Ju do të punësoni sekretarët tuaj që të pergjigjen për çështje të ndryshme ose publike, por sekretet e shtetit duhen të mbeten mes jush...

Mos përbuzni askënd ; më i vogli dhe më i varfëri mund të ju rrezojë, ashtu si dhe mund të ju ndihmojë me këshillat dhe kurajon e tij.

Jeni të durueshëm në çështjet e luftës, të patrembur në rreziq, të butë dhe humanë, kurrë mizorë dhe gjaknxehtë. Fshihni dhimbjen që fatkeqësitë tuaja mund të ju shkak-



tojnë. Armiqtë tuaj do të jenë gjithmonë të gatshëm të ju fyejnë për fatkeqësitë, dhe ministrat të ju tradhëtojnë. Ftoni mes jush të huaj të arsimuar duke u dhënë një rol këshilltari edhe në rast kur ata nuk janë fisnikë e të pasur. Kompetencat që i akordohen fisnikërisë janë prodhim i politikës. Ju mund të përdorni fisnikët si të dëshironi. Pasanikët injorantë do t'i ledhatoni, kështu do të kurseni pasurinë tuaj për mirëmbajtjen e ushtrisë, dhe do të keni një oborr të shkëlqyeshëm falë krenarëve por dhe budallenjve, që nuk kanë asnjë lloj virtyti përveçse floririt. Mos jeni të ndrojtur ndaj ndjenjave tuaja. Deklaroni haptazi oborrtarëve tuaj, se ai që do të ju gënjejë dhe do të ju dërgojë në rrugën e gabuar në administrim, pa asnjë falje do të varet në shtyllë. Poetëve që do të ju thurin vargje, për të ju bindur se jeni më i madhi, më

mi madhështor i Skënderbeut



bujari, më i mrekullueshmi, luftëtari më i madh ndër të gjithë mbretërit, u dërgoni në këmbim një copë letër, bojë dhe një pendë nga një oborrtar i panjohur, me urdhërin për të dëshmuar të vërtetën e asaj që shkruajnë, dhe në qoftë se nuk mund të bëjnë një gjë të tillë, të kufizojnë veten në dhënjen e këshillave, duke u lënë të kuptohet së nëse vazhdojnë të shkruajnë marrëzira të tilla të rrezikshme, ata do të mbyten nga vetë ju si person i shenjtë i të vërtetës.

Kujdesuni që të keni gjithmonë ushtarë të mirë dhe të disiplinuar ; që ushtarët tuaj të mos bëhen përtacë, ti stërvitni dhe ti trajtoni jo si skllëvër por si shokët tuaj. Kur të jeni në luftë, ju do të udhëheqni ushtrinë si gjeneral dhe në betejë do të luftoni si ushtar. Emri i mbretit është një titull shumë i nderuar, por ky titull ka peshë të madhe dhe detyra të vështira për të realizuar. Kryesorja

është të pranohesh dhe të respektohesh në rrethin tënd. Zoti nuk ka dhënë fuqinë supreme për të na zhytur në qullësi, për që të jemi mbrojtës të çështjes publike. Për një zemër të butë dhe një shpirt të virtutshëm, mirëqenia e përgjithshme e popullit tënd është kënaqësia më e madhe që mund të përjetohet. Neglizhenca dhe një lloj mirësie që e thërrasim « mendjelehtësia e një princi », u shkaktojnë dëme njerëzve ; dhe ju e dini se roli i mbretit është t'i mbrojë

Dëboni larg jush astrologët gjykatës dhe kimistët prodhuesë ari dhe diamantesh. Një princ është gjithmonë i pasur, kur ai është i mençur dhe i lartësuar shpirtërisht. Emri juaj do të jetë i shkruar në një pllakë prej mermeri të bardhë me shkronja të zeza mbi dyert e kështjellave tuaja të destinuara për të burgosurit. Mjerim për guvernatorin që i feshu

mbretit pafajsinë, që përkeqësoi nga koprracia dhe zelli i tij dënimin e fajtorëve...Mbroni njerëzit e dashur dhe të mirë, ndëshkoni shpirtrat e këqinj. Jeni të ndjeshëm ndaj lëndimit, por akoma dhe më shumë ndaj shërbimit të popullit tuaj dhe miqësisë të njerëzve të ngjashëm me ju.

Pika kulmore e një lufte është çorientuese, duhet ndërprerë pasiguria (rreziku). Atëherë kujdesi dhe guximi do të ju shërbejnë më mirë se sa pasuria. Duhet të dish të fitosh, por mos harroni se edhe mund të mposhtesh. Sfidoni veten tuaj : mos e humbisni toruan nga zemërimi, sepse atëherë i thjeshti bëhet i keq dhe mbreti një përbindësh...

Mos harroni se politika turke është për të mbjellë përçarje mes princave të krishterë ; e gjithë madhështia e tyre gjendet në këtë politikë të shkëlqyeshme, e cila bën me shumë pushtime sesa armët e

tyre. Së fundi, në qoftë se jeni xheloz se po ju lë një trashgimtar që ju pengon për të marrë fronin, mos harroni se kam qenë babai juaj, dhe shpatën do e përdorni vetëm për të rrëzuar armikun.

Ju do të keni lidhje të shumta me oborrin e Romës, që unë kam qenë deri tani mbështetës dhe mbrojtës. Interesat e mia më kanë detyruar të përshtas politikën time me të sajën. Rrethanat në të cilat jam gjetur veten nuk më kanë lejuar të luftoj uzurpimet turke dhe pretendimet e papës. Për të mirën e krahinave të mia kam qenë gjithmonë i lumtur me veprimet që kam ndërmarrë. Roma është fodulle vetëm me princat e dështuar. Roma, duke më pasur frikë, më ka bërë gjithmonë lajka. Ajo ndryshon maksimat dhe pozicionet sipas rasteve, por frika se humb tokat e saj ndaj sulmeve të Muhamedit, e ka detyruar atë të qëndrojë modeste ndaj meje,

duke më njohur të gjitha drejtat, titujt, dhe zotërimet e realizuara gjatë betejave të mia. Papët nuk kanë arritur kurrë të manipulojnë një ushtar të vjetër si unë, por nuk do të hezitojnë të bëjnë një gjë të tillë ndaj jush si arsye e moshës së re dhe mungesës së eksperiencës për të qeverisur, për të shërbyer. Mos harroni, se me praktikën e shumta që ata përdorin për të arritur qëllimet e tyre, më e forta, është rrëfimi. Por është e lehtë ta kuptoni : kur prifti do të dojë të dijë më shumë sesa mëkatet tuaja, kthejeni si një mashtrues në vendin e tij, dhe dënojeni si të tillë, që të shërbejë si shembull për pasardhësin e tij.

...Megjithatë, është shumë e rrezikshme të kundërshtosh hapur Papën, këtë idhull të madh të fesë sonë. Ai është një njeri si të tjerët, me pasionet dhe dobësitë e tij... Nëse Papa ju dërgon faljet, reliket, bekimet, merrni ato me respekt, dhe i nderoni me njerëzit tuaj duke e dhënë ju shembullin kryesor... Por në qoftë se Papa përpiket të rrisë numrin e priftërinjve dhe murgjve për të nxjerrë para nga krahinat tuaja...ose ju nxit që të hapni luftëra në emër të Zotit, rrufeja hakmarrëse që lloftë mbi ju dhe pasardhësit tuaj në rast pranimit. Zoti hakmerret ndaj fyersve të tij, pra nuk ka nevojë për ndihmën e njeriut. Mos kërcënoni Romën, kur ajo nuk ju kërcënon. Por shpallni luftë ndaj kujtdo që mundohet të prishë harenë e popullit, dhe legjitimitetin e fronit.

Ju do të ndaloni çdo banor i cili ndodhet nën qeverisjen tuaj, që të mos bëhet as prift e as murg pa arritur moshën dyzet vjeçare. Për tu ushqyer nga puna e të tjerëve, duhet më parë që njeriu (mashkulli) të ketë kontribuar në mbështetjen e komunitetit, prej të cilit dëshiron të ndahet për të shijuar jetën e tij... Këta priftërinj dhe murgj duhet të ju ndihmojnë të mbroni kombin në kohë lufte, sepse në kohë paqeje po ky komb i ushqen pa i përdorur. Nëse Papa kundërshton, bindeni atë me butësi, dhe vetëm në qoftë se është e nevojshme përdorni shpatën... Një politikë e tillë do të ju pajtojë me dashurinë atërore të pasardhësve të tij, dhe do të bëheni shembull dhe lider për të gjithë mbretërit, të cilët frikacakë, të dobët, injorantë, budallenj, u uzurpohet nga Papa dhe ministrat e tyre, fuqia që Zoti u ka dhënë për të përhapur lumturinë e Kombeve, ku ata duhet të jenë zotërit dhe etërit».

/gazeta-shqip.com/

EURO GLASS
 SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
 Enveri
 Adr: Fushë Kosovë
 Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
 E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
 "BUJQËSIA"
 TEL: 045/82 82 82

Fazliu: Në 'Fadil Vokrri' luajmë edhe për Kosovën

Astrit Fazliu për "Epokën e re" ka thënë se Feronikeli do të luajë edhe për Kosovën të martën në stadiumin "Fadil Vokrri" ndaj TNS-së. "Ne do ta japim maksimumin që ta kalojmë skuadrën e TNS-së, pasi këtu nuk po luajmë vetëm për klubin tonë, por për futbollin e Kosovës. Kemi pasur paraqitje të mirë, sidomos në fund të ndeshjes. Shpresoj që edhe në të martën të luajmë dhe të kualifikohemi", ka thënë sulmuesi nga Ferizaj



EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 11 KORRIK - Skuadra e Feronikelit ka regjistruar një rezultat të mirë në ndeshjen e Ligës së Kampionëve ndaj The New Saints pasi, pavarësisht që ishte duke humbur me rezultat 2-0, arriti që në pesë minutat e fundit ta barazojë rezultatin në 2-2. Tash skuadra kampione e Kosovës ka rastin historik që të kualifikohet në rrethin e dytë kualifikues të Ligës së Kampionëve. Lojtari më i mirë i "Niklit" në ndeshjen e parë në Uellsit ishte Astrit Fazliu, i cili realizoi edhe golin e barazimit nga penalltia. I kontaktuar të enjten nga "Epoka e re", Astrit Fazliu ka thënë se të gjithë futbollistët e

Feronikelit do ta japin maksimumin për t'u kualifikuar në ndeshjen që zhvillohet të martën në stadiumin "Fadil Vokrri", pasi në këtë ndeshje nuk luhet vetëm për këtë klub, por për futbollin e Kosovës në përgjithësi. "Ne do ta japim maksimumin që ta kalojmë skuadrën e TNS-së, pasi këtu nuk po luajmë vetëm për klubin tonë, por për futbollin e Kosovës në përgjithësi. Kemi pasur paraqitje të mirë, sidomos në fund të ndeshjes. Shpresoj se edhe të martën të luajmë ashtu dhe të kualifikohemi", ka thënë Fazliu. Sulmuesi me përvojë të madhe pret që të martën përkrahja të jetë e madhe për skuadrën e Feronikelit. "Është një ndeshje shumë e rëndësishme, prandaj presim të kemi

përkrahje të madhe dhe ndeshjen ta rikthejmë në spektakël sportiv, pasi kualifikimi ynë në rrethin e dytë është historik për Feronikelin dhe Kosovën", ka deklaruar ai. Ish-sulmuesi i Ferizajt, Prishtinës, Ulpianës, Shkëndijës, Dritës dhe Partizanit, ka thënë se goli i shënuar ndaj TNS-së ka qenë ndër më të rëndësishmit në karrierën e tij futbollistike. "Goli i shënuar ndaj TNS-së ka qenë ndër më të rëndësishmit në karrierën time, pasi kam shënuar edhe shumë gola të tjerë që kanë pasur peshë të madhe. Shpresoj që të shënoj sërish dhe të kualifikohem në rrethin tjetër", ka përfunduar Fazliu. Ky është edicioni i dytë për 31-vjeçarin në skuadrën nga Drenasi.

SHKURT

Nuri ndërpre bashkëpunimin me Llapin

Futbollisti nga Shqipëria, Klodian Nuri, ka ndërprerë bashkëpunimin me skuadrën e Llapit. Skuadra nga Podujeva ka njoftuar se kjo ndarje erdhi me kërkesë të futbollistit shqiptar, i cili ka shprehur dëshirën ta vazhdojë karrierën diku tjetër. "Klubi njofton për ndërprerjen me konsensus të marrëveshjes me futbollistin Klodian Nuri. Pas një diskutiimi të përbashkët mes klubit dhe futbollistit, vendosëm që mos ta pengojmë futbollistin për arsye të tij personale, i cili do ta vazhdojë karrierën diku tjetër. Njëherësh, pas përmbjlljes së marrëveshjes së dyanshme, klubi falënderon Klodian Nurin për bashkëpunim", thuhet në njoftimin e Llapit.

Halimi, afër ndarjes me Brondbyn

Reprezentuesi i Kosovës në futboll, Besar Halimi, pritet të largohet nga skuadra e Brondbyt. Mesfushorit i përfundon kontrata në qershor të vitit të ardhshëm, por Halimi që disa ditë nuk po stërvitet me klubin aktual. Sipas "3point.dk", Brondby ia ka konfirmuar 24-vjeçarit lajmin se është i lirë të kërkojë ndonjë angazhim të ri. Kujtojmë se lojtari ishte transferuar para dy vjetëve nga gjeramanët e Mainzit, të cilët kishin fituar rreth 300 mijë euro.

Xhudistët kërkojnë pikë të reja olimpike

Kampionët e xhudos së Kosovës do ta vazhdojnë rrugën drejt normës olimpike "Tokio 2020", duke marrë pjesë në Grand Prixin e Budapestit, që mbahet prej sot (e premte) e deri të dielën. Të tre medalistët në Lojërat Evropiane "Minsk 2019", Majlinda Kelmendi (e artë), Nora Gjakova (e argjendte), Loriana Kuka (e bronzte), si dhe Distria Krasniqi e Akil Gjakova, do t'i kërkojnë medaljet e reja. Sot në gara do të jenë Majlinda Kelmendi (-52 kg), Nora Gjakova (-57 kg) dhe Distria Krasniqi (-48 kg).

UEFA mbështet Ademin

PRISHTINË, 11 KORRIK - Kryetari i Federatës së Futbollit të Kosovës, Agim Ademi, e ka marrë përkrahjen e plotë nga UEFA. Kryetari i FFK-së, Agim Ademi dhe sekretari i përgjithshëm, Eroll Salihu, po qëndrojnë në selinë e UEFA-s me ftesë të drejtorit të federatave kombëtare, Zoran

Laković, ku zhvilluan takime të shumta për realizimin e projekteve të reja në kuadër të strategjisë së re. "Zyrtarët e UEFA-s u njoftuan për gjendjen aktuale në FFK, me ç'rast ata u informuan për gjithçka që ka ndodhur kohët e fundit. Përveç shqetësimit të tyre për rastin që ka ndodhur, zyrtarët e

UEFA-s u zotuan se kryetari i FFK-së dhe Komiteti Ekzekutiv e kanë përkrahjen e vazhdueshme dhe e presin verdiktin e fundit të drejtësisë, duke shpresuar që çështja do të zgjidhet drejt, në mënyrë që FFK-ja ta vazhdojë rrugën e saj të suksesit", thuhet në njoftimin e FFK-së.



'Dardanët' e rinj në Evropian debutojnë ndaj Estonisë

PRISHTINË, 11 KORRIK - Pas përgatitjeve në Prishtinë, Kosova U20 në konkurrencën e meshkujve nga 12 deri më 21 korrik do të marrë pjesë në Kampionatin Evropian, Divizioni B që mbahet në Matosinhos në Portugal. Djelmoshat të udhëhequr nga Ibrahim Karabegu do të jenë në Grupin C, së bashku me Estoninë, Suedinë, Holandën, Gjeorgjinë dhe Armeninë. Synimet e "Dardanëve" të rinj janë ta për-

faqësojnë sa më mirë shtetin në këtë Evropian. Ndeshja e parë do të jetë ndaj Estonisë, kurse kundërshtarët e përafërta me Kosovën shihen Gjeorgia dhe Armenia. Në këtë Kampionat Evropian marrin pjesë 21 kombëtare, që janë të ndara në katër grupe, 3 grupe me përfaqësues dhe pikërisht Grupi C me 6, aty ku ndodhet edhe Kosova. Tri kombëtalet e para do të kualifikohen në Divizionin A. Dy

vendet e para në grupe do të kualifikohen në çerekfinale, vendi 3 dhe 4 do të luajnë për pozitat 9-16, kurse 5-6 për vendet 17-21. Kosova të premten përballet me Estoninë (17:00), kurse të shtunën me Holandën (17:00), të dielën me Armeninë (19:15). Të hënën Dardanët e rinj pushojnë, kurse të martën përballet me Gjeorgjinë (17:00), kurse ndeshjen e fundit e zhvillojnë ndaj Suedisë të mërkurën nga ora 19:15.



Muhaxheri: Në Botëror do ta nxjerrim maksimumin

PRISHTINË, 11 KORRIK - Trajneri i Përfaqësueses U21 të Kosovës në Hendboll, Fatmir Muhaxheri, është i kënaqur me punën që po bëjnë hendbollistët para paraqitjes historike në Kampionatin Botëror që mbahet në Spanjë prej 16 deri më 28 korrik. Kosova është në fazën përfundimtare të përgatitjeve, ndërsa të hënën udhëton për në Spanjë. "Dardanët" e rinj ka nisur përgatitjet për Botëror më 16 qershor dhe tani puna është e fokusuar në përgatitje tekniko-taktike për ndeshjet në ngjarjen më të madhe. Është hera e parë që një kombëtare e Kosovës paraqitet në kampionat botëror në ndonjë nga sportet ekipore. Kosova U21 ndeshjen e parë e luan më 16 korrik ndaj Kroacisë në Pontevedra. "Përgatitjet deri më tani kanë shkuar shumë mirë. Nuk kemi pasur telashe me ndonjë lëndim dhe kjo është me shumë rëndësi. Tani po punojmë në aspektin teknik dhe taktik që të bëhemi gati për ndeshje. Problem mund të jetë mungesa e miqësoreve, por në përgjithësi kemi bërë punë shumë të mirë gjatë përgatitjeve", ka thënë trajneri Fatmir Muhaxheri.

Ai ka shtuar se akomodimi dhe kushtet janë në nivel shumë të lartë. "Jemi të kënaqur me



përkushtimin e lojtarëve dhe punën që është bërë me ta. Kemi qenë të angazhuar plot pesë trajnerë. Jemi në fazën përfundimtare të përgatitjeve dhe do të jemi të gatshëm për Botëror, ku natyrisht na presin ndeshjet të vështira. Djemtë janë të vetëdijshëm që po shkruajnë kapitull të ri në historinë e sportit kosovar dhe jemi të përkushtuar që të bëjmë më të mirën e mundshme", ka shtuar Muhaxheri. Puna në Prishtinë vazhdon deri

të shtunën paradite. Lojtarët do të jenë të lirë të shtunën pasdite dhe të dielën paradite, ndërsa një stërvitje tjetër është paraparë për të dielën pasdite. Të hënën në mëngjes është udhëtimi për në Spanjë, ku kombëtarja jonë do të ketë dy stërvitje të shkurtra para ndeshjes hapëse me Kroacinë. Më pas Kosova luan me Hungarinë, Portugalinë, Brazilin dhe Bahrejinin, ndërsa në fund janë edhe ndeshjet për plasman.

Halep - Williams, finalja e Wimbledonit

LONDËR, 11 KORRIK - Simona Halep ka shkatërruar Elina Svitolina 6-1 6-3 dhe është kualifikuar për në finalen e turneut të Wimbledonit. Një paraqitje e përkryer për 27-vjeçaren rumune, numri 7 i renditjes botërore para këtij turneu, e para finaliste e Wimbledonit nga Rumania. Një gjysmëfinale që pritej me interesim të madh, sepse 24-vjeçarja ukrainase Svitolina ka pasur një ecuri mbresëlënëse këtë vit, por realisht ishte një sfidë zhgënjyese dhe u vërtetua ajo që thuhet me gjysmëzëri: Svitolina pati edhe avantazhin e shortit për të shkuar në gjysmëfinale, sepse në rrugën e vet hasi emra si Gavrilova, Gasparyan, Sakkari, Martić e



Muchova, asnjë prej tyre mes 20 më të mirave në botë. Pas Simona Halep finalen në konkurrencën e femrave në Wimbledon e ka siguruar edhe Serena Williams. Kjo e fundit është treguar e fortë për tenisiten Barbora Strycova, duke e

mposhtur lehtësisht 6-1 dhe 6-2. Kjo është finalja e 11 e Williamsit në Wimbledon, teksa shtatë herë e ka ngritur lart trofeun. Williamsi do të kërkojë në finale titullin e 24 Grand Slam në karrierë në përballje me Serena Williamsin.

SHKURT

Rivaldo: Messi duhet ta fitojë 'Topin e Artë'

Ish-ylli i Kombëtares së Brazilit, Rivaldo, është shprehur se Lionel Messi duhet ta fitojë "Topin e Artë" këtë vit para Cristiano Ronaldos dhe Virgil Van Dijk. "Sipas mendimit tim, Messi duhet ta fitojë 'Topin e Artë' këtë vit për shkak të gjithë asaj që e ka bërë. Ai nuk e fitoi Ligën e Kampionëve, por ky është çmim individual. Ai ka shënuar shumë gola të rëndësishme dhe mendoj se e meriton këtë çmim", ka thënë Rivaldo.

Malcomi në 'radar' të Arsenalit

Arsenali po planifikon blerje për ta forcuar ekipin në mënyrë që të mos pësojë një sezon zhgënjyës si ky i fundit. "Topçinjtë" janë hedhur në kërkim për një sulmues dhe, sipas medieve britanike, në radarin e tyre është sulmuesi i Barcelonës, Malcom. Braziliiani nuk arriti të gjente hapësira te Barcelona nga konkurrenca e fortë, por nuk ishte as i preferuar nga trajneri Valverde. "Sun" shkruan se Arsenali është i gatshëm të paguajë 31.5 milionë paund për ta nënshkruar me brazilianin.

Arsenali e ka seriozisht për Zahan

Arsenali është i vendosur që ta blejë Wilfried Zahan, duke i ofruar Crystal Palace 40 milionë paundë dhe tre lojtarë. Sipas "The Sun", londinezët janë gati të privohen nga Chambers Calum, Mohamed Elneny dhe Carl Jenkinson në një përpjekje për ta arritur marrëveshjen me Crystal Palacen.

De Laurentiis: Icardi e dëshiron Juven para Napolit

Sulmuesi Mauro Icardi vazhdon të jetë i pavendosur për të ardhmen e tij, kurse presidenti i Napolit, Aurelio De Laurentiis, e ka zbuluar të ardhmen e sulmuesit argjentinas. "Icardi gjithmonë do të dëshirojë të shkojë te Juventus, por unë dua më shumë Insigne, sepse ai është lojtari që na duhet. Ndërsa në sulm kemi Mertens dhe Milik. Icardi është shumë i fortë, por kaq shumë kemi folur për të sa tani ai duket më shumë 26 vjeç. Nuk ka rëndësi roli që ai ka në fushë, por potenciali i tij është i padiskutueshëm", kanë qenë fjalët e De Laurentiis.

Fenerbahçe ofron 10 milionë për Khediran

Mesfushori gjerman i Juventusit, Sami Khedira, mund të transferohet në Turqi. Mediet italiane kanë raportuar sot se Khedira është synim i Fenerbahçes, e cila ka ofruar 10 milionë euro për kartonin e ish-lojtarit të Real Madridit. Largimi nga Torino duket shumë i mundshëm në këtë afat kalimtar sepse "Zonja e Vjetër" tashmë ka transferuar Adrien Rabiotin dhe Aaron Ramseyen.

Matthaus: Bayerni ta transferojë Sanen para Demebeles

Bayern Munchen po interesohet për Leroy Sanen e Manchester Cityt dhe Ousmane Dembele e Barcelonës. Legjenda e Bayernit dhe Gjermanisë, Lothar Matthaus, ka deklaruar se do të ishte mirë që Bayerni ta transferojë Sanen para Demebeles. "Sane do të ishte një blerje më e mirë për Bayernin, ai ka karakter më të mirë. Kur mendoj për sjelljen e Demebeles te Dortmundi e më pas te Barcelona, nuk më shtyn asgjë të mendoj se do të ndryshojë sjellje te Bayerni. Për më tepër Sane njih shumë lojtarë nga kombëtarja dhe do të përshtatej më mirë. Nëse më duhet të zgjedh mes një francezi dhe një gjermani për ta marrë te Bayerni, sigurisht se do ta zgjidhja gjermanin, francezi mund të kërkojë të largohet që vitin tjetër", ka thënë Matthaus.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Integrimit Evropian
Ministarstvo Evropske Integracije/Ministry of European
Integration

Anulimi i Konkursit të Jashtëm

Anulohet konkursi i jashtëm për pozitën Asistent/e Ekzekutiv, me numër të referencës 07/2019/DBF /MIE, të shpallur me 13.06.2019 deri me datë 27.06.2019, në Ministrinë e Integrimit Evropian.

Poništenje eksternu konkursa

Poništava se eksternu konkurs za poziciju Izvršni Asistent/e , sa referentnim brojem 07/2019/DBF/MIE, objavljenog od 13.06.2019. godine do 27.06.2019. godine, u Ministarstvu za evropske.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se “Qëndrimi” N.T. ka marrë vendim të shuajë biznesin me numër: NRB. Biznesit 70051940 dhe numër fiskal: 600227145 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë në këtë Kooperativë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Qëndrimi” T.O. donelo odluku o prestani rada sa bisnisom : NRB. Biznesit: 70051940 sa fiskalom broju: 600227145 ujedno imenovao o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljanja o novine.

ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the “Qëndrimi“ N.T. has come to the decision to quit its business: NRB. Biznesit: 70051940, i number fiskal: 600227145 the company has appointed a likuidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria
Vlada-Government
Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
Ministarstvo Trgovine i Industrije Ministry of Trade and Industry

NJOFTIM PËR PËRMIRËSIM TË KONKURSIT

Në konkursin e shpallur nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, me datë 11.07.2019 në gazetën ditore EPOKA E RE, pozita Udhëheqës i Divizionit për Mallra Ushtarake, Trasit dhe Brokerim është lëshuar një gabim teknik tek kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim, ku thuhet:” Të drejtë aplikimi kanë të gjithë zyrtarët e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë.”

Ministria ju informon që konkursi është i jashtëm, dhe të drejtë konkurrimi deri me datë 25.07.2019 kanë të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës, të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, kanë shkollimin e lartë dhe kanë aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave.

OBAVEŠTENJE ZA ISPRAVAK KONKURSA

U konkursu koji je Ministarstvo Trgovine i Industrije objavilo 11.07.2019 u dnevnom listu EPOKA E RE, pozicija: Šef Divizije za Vojnu Robu, Tranzit i Posredovanje, došlo je do tehničke greške o uslovima učešća u zapošljavanju, koja glasi: Svi službenici Ministarstva Trgovine i Industrije imaju pravo da se prijave. "

Ministarstvo vas obavestava da je konkurs javni, i pravo na konkurenciju do 25.07.2019 imaju svi građani Republike Kosovo, koji imaju punu pravnu sposobnost, imaju visoko obrazovanje i profesionalnu sposobnost za obavljanje dužnosti.



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Prizrenit
Skupština Opština
Municipal Assambly

DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE

DATE:	11/07/2019
REFERENCË:	Zyrtar
NGA:	Drejtoria e Shërbimeve Publike
TEMA	Njoftim

NJOFTIM

Njoftohen kompanit që kanë aplikuar ne ofertën “Shërbimi i transportit me mjete martëse (merimanga)” se tenderi në fjalë në njoftimin e bërë, shpallje për dorëzim të dokumenteve të datës, 24 Maj 2019 dhe plotësim të shpalljes së datës 28 Maj 2019.

ANULOHE

Arsyetim

Në shpalljen për vlerësim të ofertave nuk ka elemente që të bëj diferencës e operatorëve ekonomik.

Andaj e njëjta të përsëritet në përputhje me rregullat e parapara me ligjin e Prokurimit Publik të Kosovës.

Ju faleminderit në mirëkuptim...

OFERTE PËR SHITJEN E PATUNDSHMËRISË

1. Sahit (Aziz) Mazreku me adrese ne rr. "Ismail Qemali" nr 29. K.K Prizren i pajisur me letërnjoftim - numër personal: 1002712179 të lëshuar nga MPB e Kosovës - Prishtinë, të cilin e përfaqëson Asdren (Sadik) Hoxhaj nga fsh. Vlashnje K.K. Prizren. Është bashkëpronar me pjesën prej 1\3 e pjesës ideale të patundshmërisë, me numër të Njesisë kadastrale P-71813023-00483-2, në vendin e quajtur "Sello-Okuqnica", në sipërfaqe të përgjithshme prej 1913 m2, Zona kadastrale Dushanovë.

Nga pjesa e vet ideale ofron për shitjen sipërfaqen e përgjithshme prej 173 m2 të patundshmërisë me të dhënat si me lart, në shumën e përgjithshme prej 6.000 € (me shkronja gjashtëmijë euro).

Prizren 12.07.2019

Ofertuesi 1. Salih Mazreku

Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" - Prishtinë
Fakulteti i Filologjisë

Njoftim

Njoftojmë të interesuarit se më datën: 18.07.2019 (e enjte), në orën 11:00 në sallën e dekanatit të Fakultetit të Filologjisë të Universiteti të Prishtinës "Hasan Prishtina"

Kandidatja Gjylë Totaj, mbron publikisht punimin e doktoraturës me titull: **"KRIJIMTARIA LETRARE (PROZË) E FATOS KONGOLIT"**.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- ▶ Xhezide Gashi shpallë të pavlefshme dëftesat e vitit të parë dhe të dytë të shkollës së mesme të muzikës "Prek Jakova" Prishtinë.
- ▶ Violeta Hasani shpallë të pavlefshme dëftesat dhe diplomën e shkollës së mesme "Kuvendi i Arbërit"- Gjinnazi gjuhësor.
- ▶ Ragip Shaip Mulaku shpallë të pa vlefshme certifikatën e invalidit të luftës së UÇK-së.
- ▶ Arlindë Ahmetaj shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme "Anton Çetta" Skenderaj, drejtimi banka e sigurime dhe dëftesat e klasës së X,XI dhe XII.
- ▶ Genta Kuqica shpall te pavlefshme diplomën e shkollës së mesme gjinnazi "Hamëz Jashari" Skenderaj dhe dëftesat e klasës: X, XI dhe XII.
- ▶ Mustafë Gjyshinca shpall të pavlefshme dëftesat e klasës së -X- me numër 155/1 të "British School of Kosova".
- ▶ Zejnel Shatri shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shf "Bajram Curri" Prizren
- ▶ Avdulla Gjogaj shpall te pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi" Prizren
- ▶ Arlinda Morina shpall te pavlefshme dëftesat e kl XI Gymnazium Loyola Prizren
- ▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qera ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188
- ▶ Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275
- ▶ Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139
- ▶ Shitet banesa në Lakërishte përballë Procredit Bankës, hyrja e parë kati i 9 banesa ka 50m2 me dokumentacion të rregullt, çmimi 52 000€. Për info 044/672-439.
- ▶ Lëshohet me qira banesa në lakërishte afër Procredit bankës është e mobiluar 50m2 për një çift çmimi është 220€. Për info 044/672-439.
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.
- ▶ Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.
- ▶ Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- ▶ Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
- ▶ Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.
- ▶ Lëshoj banesën e re me qera në qendër teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

Ismet Miftari shpall të pavlefshme
Certifikatën e biznesit nr:
70055798, në emër të O.G.J.O.
"Venera" në Skenderaj.

Kërkesa për shprehje të interesit

Emri i shkollës: "Hasan Prishtina"

Komuna: Malishevë

Data: 12.07.2019

Numri i kontratës:	Emri i kontratës:
ESIP/SDG/150-CS/1.2	Trajnimi i mësimdhënësve për Gjithëpërfshirje

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit (ESIP), dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe Shkollës "Hasan Prishtina" Terpezë – Malishevë.

Objektivi i nën-komponentit 1.3. (GZSh) të projektit ESIP është forcimi i kapaciteteve të shkollave që financohen me fonde publike që t'i planifikojnë dhe t'i menaxhojnë burimet si dhe ta promovojnë angazhimin qytetar përmes pjesëmarrjes së mësimdhënësve, prindërve dhe komunitetit në planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e aktiviteteve të shkollës

Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi i shërbimeve të konsulencës të nevojshme:

- Trajnimi i mesimdhënësve për Gjithëpërfshirje

Kualifikimet e firmës konsulente:

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin e kontratave për ofrimin e shërbimeve të konsulencës të natyrës së ngjashme në vitin e fundit;
- Përvojë në trajnimin dhe punën me personelin arsimor
- Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore.
- Liqenca e akreditimit për trajnimet e cekura.

Firmat konsulente të pranueshme do të vlerësohen dhe radhitën në listën e ngushtë në bazë të kërkesave kualifikuese si më lartë.

- Firmat konsulente duhet të tregojnë se kanë në dispozicion staf profesional, përkatësisht trajnerë të certifikuar dhe me përvojë në ofrimin e trajnimeve për mësimdhënës në fushën Gjithëpërfshirjes

Kriteret e vlerësimit:

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin dhe zbatimin e kontratave për ofrimin e shërbimeve të konsulencës nga fusha trajnimi i mësimdhënësve (40%);
- Përvoja specifike në ofrimin e trajnimeve Trajnimi i mesimdhënësve për Gjithëpërfshirje (40%);
- Disponueshmëria e personelit kyç profesional të kualifikuar për detyrat (20%)

Procesi i seleksionimit:

Aktiviteti i prokurimit të do të realizohet në përputhje me: Udhëzime: përzgjedhja dhe punësimi i konsulentëve nga huamarrësit e Bankës Botërore" të muajit janar 2011 dhe të rishikuara në korrik të vitit 2014, dhe me dispozitat e përcaktuara në marrëveshjen për financim, sipas përzgjedhjes të bazuar në metodën e Kualifikimeve të Konsulentëve (KK).

Firmat Konsulente të interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhura të aplikojnë me Shprehjet e tyre të Interesit për shërbime konsulente në adresën: shfmu "Hasan Prishtina" Terpezë – Malishevë. më së largu deri më 22.07.2019

Firmat e interesuara të konsulencës mund të marrin informacion shtesë ose Termat e Referencës të detajuar për këto detyra në adresën e shënuar më poshtë.

Detajet kontaktuese të shkollës:

Personi kontaktues: Emina Krasniqi, Telefoni: 044/652993, 049296845

E-mail: emi-2008@live.com



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

